



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.6(432)

QERSHOR 2024

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

KINEMA VERORE



ARDIT BIDO: JAPIM MESAZHIN E LANÇ

DPA: Do të shfaqen 10 filma që risjellin epopën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare

FAQE 2

HISTORIA



DJEMTË E GEGHYSENIT, "NDERI I KOMBIT"

Si e e asgjësuan "Djelmëria e Geghyseut", marshallin turk Mehmet Ali Pasha (Maxharr Pasha) më 1878- tën.

Halil RAMA - Mjeshtër i Madh

FAQE 6

BRIGADA XV SULMUESE



U PAGËZUA NË OPERACIONIN E QERSHORIT 1944

Operacioni armik i Qershorit 1944 ende vazhdon në Shqipëri dhe Jugut. 80 vjet më parë kur në mjaft krahina ku zhvilloheshin luftime...

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

FAQE 4

Logoja Kombëtare e 80-Vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë mban autorësinë e Ejona Karkinit

SIMBOLIKË PËRFAQËSUESE QË DO TË SHOQËROJË EVENIMENTET ZYRTARE

Dita e fitores kundër fashizmit 79 vjet pas

Nga Bashkim Hisari

Shumë vite, 9 maji ishte ditë kremteje. Festehej fitorja kundër fashizmit. Tani 9 maji festohet edhe si Dita e Evropës. Tetë dekada më vonë ka ende nga ata të cilët kishin guximin, vizionin dhe forcën për t' i rezistuar të keqes, skllavërimit, krimeve dhe vuajtjeve nga fashizmi. Të tillët 9 majin e konsiderojnë dhe festojnë si ngjarje të shënuar dhe e paharruar. Anëtar i rinisë antifashiste që nga viti 1942, Xhafer Haxhijakupi, tani anëtar i Kryesisë së Veteranëve të LANÇ të Kosovës i lindur në vitin 1926, sot është zotri i moshës së tretë. Prej shumë kohe nuk feston ditëlindjen, por e ka reduktuar vetëm për të përkujtuar datëlindjen që të mos u harrohet. Daljet e tija nga shtëpia në lagjen Ulpian të Prishtinës janë rraluar. Me bashkëlutëtarët e tij shihet radhë, ndonjëherë rastësisht, një here në 6 muaj në sportelet e zyrës së Departamentit të Administratës pensional, ku pret në rresht për të dëshmuar se është gjallë për të realizuar të drejtën e pensionit në shumën rreth 200 euro ose në tregoret e barnave kur blen ilaçe për qetësim, parandalim dhe shërim të sëmundjeve. Me ta gjithnjë e më rralë takohemi në shënimin e ngjarjeve të rëndësishme nga LANÇ, kur vendosen kurora me lule mbi varret e luftëtarëve, dëshmorëve dhe heronjëve që institucionet kosovare pothuaj fare nuk shënojnë në mënyrë të organizuar. Dita e fitores kur më 9 maj 1945 në Berlin u nënshkrua Akti i Kapitullimit pa kusht i Gjermanisë naziste, që do të shënohte edhe fundit e Luftës së Dytë Botërore dhe të rënies së regjimit jodemokratik, i cili kërcënoi të shembte të gjitha arritjet e shoqërisë moderne, siç jet pothuajse u "harrua" në Kosovë. Kaloj në heshtje dhe duket se do të lëviz në harresë.

VIJON NË FAQEN 5



Ejona Karkini -DIZAJNER / ARKITEKTE


• Logoja që përmban elementët patriotikë kombëtarë u vlerësua nga komisionet respektive si përfaqësimi më dinjitoz i imazhit të vitit mbarëkombëtar të 80-Vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë

FAQE 3

PËRJETËSIMI I DËSHMORIT TË ATDHEUT ALLAMAN DERVISHI

Nga TRIFON LLUPO

FAQE 16



SUPLEMENTI LETRAT

SHQETËSIMI INTELKTUAL E ATDHETAR I PANO HALLKOS

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 14

FORCA E MENDIMIT TË ÇON DREJT FILOZOFISË

Kadri Tarelli

FAQE 15

105 VJETORI I LINDJES

PËR HEROIN E HESHTUR LIMAN FALI BUSHI

FAQE 9

85-VJETORI I LINDJES

QEMAL GEGOLLARI, INTELKTUALI QË PROMOVOI VLERA QYTETARIE

FAQE 8

DOSSIER

IBALLA E ETUR PËR MËSIM E DITURI

Xhemal MEÇI

FAQE 12

REFLEKSIONE

NGA DITARI I SHKRIMTARIT DAUT HOXHA

FATMIR MINGULI

FAQE 10

REFLEKSIONE

EMRA VETERANËSH TË GDHENDUR NË KUJTESËN E KOHËS

Nga MEVLUD BUCI

FAQE 2

ESSE

MADHËSHTIA E NJË HEROINE LABE

Neki ÇAKO

FAQE 11

KINEMA VERORE

DPA: Do të shfaqen 10 filma që risjellin epopenë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare

Bido: Japim mesazhin e Luftës Nacionalçlirimtare

• Me rastin e këtij viti me rëndësi kombëtare, ne përcjellim një mesazh shumë të rëndësishëm: kur atdheu është në rrezik, të rinjtë duhet të dalin përballë tij. Kjo ndodhi 86 vjet më parë dhe kulmoi 80 vjet më parë, kur një grup të rinjsh dhe të rejash dolën përballë në mbrojtje të atdheut, kur rrezikohej liria e tij. Janë pikërisht ata që kanë mundësuar që sot të kemi një vend të pavarur që mund ta drejtojnë vetë shqiptarët

• Kalendari i aktiviteteve të Kinemasë Verore pranë DPA-së do të zgjasë deri në muajin nëntor. Repertori i filmave të përzgjedhur do të risjellë në vëmendjen e publikut kryeqytetas disa prej realizimeve artistike të kinematografisë shqiptare. Mes 10 filmave që do të shfaqen, si një përkujtesë të betejës së vendit për çlirimin nga pushtuesit nazifashist, bëjnë pjesë: “Partizani i vogël Velo”, “Mëngjese luftime”, “I teti në bronz”, “Njeriu me top”, “Malet me blerim mbuluar” etj

Kinematografia verore e DPA-së çeli siparin e një sezoni të ngjeshur artistik me shfaqjen e një prej filmave më ikonikë të kinematografisë shqiptare, “Tomka dhe shokët e tij”. Me rastin e Vitit Mbarëkombëtar të 80-vjetorit të Çlirimit, kjo hapësirë e re kulturore pranë DPA-së do t’i kushtojë një rëndësi të posaçme realizimeve filmike që i referohen Luftës Nacionalçlirimtare. Në këtë aktivitet të zhvilluar në oborrin e ridimensionuar të godinës së DPA-së, ishin të pranishëm ministri i Brendshëm, Z. Taulant Balla, Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, Z. Ardit Bido, Drejtoresha e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit (AQSHF), Znj. Marinela Ndria, përfaqësues të Shoqatës së Dëshmorëve të Atdheut, dhjetëra studentë dhe nxënës.

Fjala përshëndetëse u mbajt prej Bidos, i cili u shpreh se përmes kësaj nisme, DPA-ja synon të përcjellë një mesazh me rëndësi kombëtare. “Ne nisim sot një seri aktivitete, në kuadër të 80-vjetorit të Çlirimit. Këto aktivitete do të zhvillohen këtu, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, por do të mbahen nga DPA-ja kudo nëpër Shqipëri. Me rastin e këtij viti me rëndësi kombëtare, ne përcjellim një mesazh shumë të rëndësishëm: kur atdheu është në rrezik, të rinjtë duhet të dalin përballë tij. Kjo ndodhi 86 vjet më parë dhe kulmoi 80 vjet më parë, kur një grup të rinjsh dhe të rejash dolën përballë në mbrojtje të



atdheut, kur rrezikohej liria e tij. Janë pikërisht ata që kanë mundësuar që sot të kemi një vend të pavarur që mund ta drejtojnë vetë shqiptarët. Është momenti për të përcjellë këtë mesazh në forma të ndryshme. Do të shfaqen 10 filma që risjellin epopenë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Lavdi dëshmorëve të Atdheut.”- tha kreu i DPA-së.

Në vijim, mori fjalën Z. Balla, i cili përshëndeti angazhimin e DPA-së në drejtim të njohjes së kontributit të Luftës Nacionalçlirimtare. “Jam shumë i lumtur që jam këtu për të përcjellë



një mesazh për Luftën Nacionalçlirimtare. Është shumë mirë të flasim për atë moment historik përgjatë epopeve shqiptare për liri dhe pavarësi. Kjo luftë e radhiti Shqipërinë

përkrah aleatëve globalë në luftën ndaj fashizmit. Shqipëria u çlirua falë heroizimit të atyre djemve dhe vajzave që morën armët për të dhënë kontributin e tyre. Ka patur shumë përpjekje për të përbaltur këtë luftë, por shqiptarët dinë ta bëjnë dallimin e ditës së Çlirimit të vendit dhe mbi të gjitha dinë të njohin kontributin e Luftës Nacionalçlirimtare.

Prandaj, aktivitete si ky i sotmi në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave kanë mbështetjen e Komitetit Shtetëror për organizimin e veprimtarive gjatë këtij viti. I nxis institucionet e tjera që të promovojnë vlerat e kësaj lufte, që të mund t’ua transmetojmë brezave.”- u shpreh ministri.

Më tej, mbajti një fjalë rasti edhe drejtoresha e AQSHF-së, e cila e vlerësoi bashkëpunimin me DPA-në në këtë përvjetor të rëndësishëm për vendin. “Jam shumë e lumtur që një listë e përzgjedhur filmash do të shfaqet në DPA. 80-vjetorin e Çlirimit e nisim me ‘Tomka dhe shokët e tij’. Në vijim do të kemi filma, si: ‘Lulëkuqe mbi mure’, ‘Nusja dhe shtetrrëthimi’, ‘Gjenerel Gramafoni’ etj. Këto filma do të jenë të restauruar. Përmes tyre do mësojmë jo vetëm mbi historinë e vendit, por edhe do të risjellim muzikën, që i është kushtuar Luftës Nacionalçlirimtare.”- tha Ndria.

Kalendari i aktiviteteve të Kinemasë Verore pranë DPA-së do të zgjasë deri në muajin nëntor. Repertori i filmave të përzgjedhur do të risjellë në vëmendjen e publikut kryeqytetas disa prej realizimeve artistike të kinematografisë shqiptare. Mes 10 filmave që do të shfaqen, si një përkujtesë të betejës së vendit për çlirimin nga pushtuesit nazifashist, bëjnë pjesë: “Partizani i vogël Velo”, “Mëngjese luftime”, “I teti në bronz”, “Njeriu me top”, “Malet me blerim mbuluar” etj.

Në kuadër të këtij jubileu kombëtar, DPA-ja do të angazhohet edhe përmes prezantimit të ekspozitave, publikimit të albumeve fotografike dhe të botimeve, në lidhje me tematikën e betejës të të parëve për liri ndaj thundrës së pushtuesve.

Kinematografia Verore, e cila zotëron një kapacitet prej 140 ulësesh i adresohet veçanërisht të rinjve, përmes një shërbimi që ndërthur edukimin me zbatimin. Jetësimi i kësaj hapësire vjen në vazhdim dhe nismave të herëpashershme të DPA-së, në funksion të inkurajimit të nxënësve dhe të studentëve për të njohur historinë dhe trashëgiminë dokumentare kombëtare.

Së bashku me Hapësirën e Studimit në Natyrë, me sallën shumëfunktionale të përruarur së fundmi, si edhe me Muzeun Arkivor që pritet të hapë dyert së afërmi, DPA-ja ofron një alternativë kulturore bashkëkohore.

REFLEKSIONE

Epokat historike prodhojnë jo vetëm ngjarje të mëdha por edhe rrisin e evidentojnë njerëz që kryejnë akte heroizmi

EMRA VETERANËSH TË GDHENDUR NË KUJTESËN E KOHËS



MEVLUD BUCI

Në kurorën e maleve, atje ku u lindën u rritën luftuan dhe punuan, shumë veteranë nuk jetojnë më, por ata rojnë në gjurmët e trimërisë dhe të djersës.

Ata jetojnë në kujtesë si një diell i ngrohtë si një rrezatim dhe evokim i historisë dhe mbijetesës, si simbole qëndrore dhe mirësie e përkushtimi.

Të shkruah për veteranin Bajram Zenel Lala të Qafë Murrës, me siguri e ilustron natyrshëm këtë ide.

Bajram Zenel Lala është veteran i punës. Ai banon në Shkodër, por nuk e harron vendlindjen, Qafë Murrën. Kështu si ai janë edhe Ahmet Biba, Ali Bajram Totraku, Dalip Bruçi, Zeqir Bardhui e heroi i hidrocentraleve Haxhi Muneka, njerëz të thjeshtë si e vërtetë, me ndihmesë të madhe në punë, duke punuar pa u lodhur me dekada e duke qenë krenarë për atë gjurmë që lanë të pashlyer kudo nëpër atdhe. Nuk është rastësi kjo vazhdimësi. Gjyshi e Bajramit nga nëna, atdhetari Rrahman Shehu i Katundit të Vjetër nga Qafë Murra, në kulmin e dimrit strehoi partizanë dhe luftëtarë të lirisë në kullën e tij. Me 70 pjesëtarë të familjes priti shtabin e luftës me komandant Haxhi Lleshin. Kur armiku e gjuajti kullën me top, trimi Rrahman Shehu iu drejtua Haxhi Lleshit: “Or Llesh Dibra, digje kullën mos u dorëzo, le të shkrihet bashkë me njerëzit e mi”. Por ky akt heroik atij iu harrua në monizëm dhe u shpall kulak vetëm pse kishte pasuri.

Shumë veteran të LNÇL kanë punuar anekënd vendit duke gdhendur emrin në vepra të mëdha. Prej shembullit të tyre, rritet vlera e njeriut dhe ata janë burim frymëzimi dhe krenari për mirënjohje.

Tek eci në katin e shtatë të Lukanit malor rrëzë Runjës shkëmbore, hedh vështrimin tek kullat e gurta ku u rritën këta veteranë, ku mësuam prej të parëve të tyre luftëtarë të lirisë, si Ali Pepa, Rrah-

man Dervishi, Rexhep Ndrejoni, Kadri Dervishi, Bajram Buci -i Riu, Selim Totraku, Bajram Losha etj.

Ata që në moshë të re dolën malit për liri, për atdhe e për flamur. Në Çetën e Dibrës, në brigadat partizane e në Komandën e vendit qëndruan dhe luftuan me trimëri kundër fashizmit e nazizmit. Edhe pse muzetë zonale janë shkatërruar, ata mbetën në kujtesën e brezave për dëshmitë e provave të trimërisë së tyre si zë kushtrimtar i lirisë i bashkimit e i unitetit. Kullat e Muçës, Metës, Laskut, Ramës, Kalisë, Ndrejonit, Bruçit, Bucit, Shehut, Lalës, Dervishit, Manrekës, Nelhanit etj kanë qenë dhe mbeten baza rritjes së luftëtarëve të lirisë, kështjella natyrore epike laudimëdha.

Epokat historike prodhojnë jo vetëm ngjarje të mëdha por edhe rrisin e evidentojnë njerëz që kryejnë akte heroizmi deri në vetëflijim për shkak se këto ngjarje me dramacitetin e tyre kërcënojnë ekzistencën qoftë fizike, qoftë atë kombëtare. Rrethanat historike kërkojnë që ata të orientohen drejt në to dhe ky orientim sado që mjegullat e kohërave janë të dendura ndriçohet nga dëshira e zjarrtë për liri, prandaj edhe ëndrra e tyre e shumëpritur një ditë bëhet realitet edhe pse shumëkush vritet a jeton a shpallet “armik” nga shokët e tij, prapëseprapë shëmbëlltyra e tyre heroike nuk shuhet kurrë...

PËRKUJTIMORE

Logoja Kombëtare e 80-Vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë mban autorësinë e Ejona Karkinit

Simbolikë përfaqësuese që do të shoqërojë evenimentet zyrtare

• Logoja që përmban elementët patriotikë kombëtarë u vlerësua nga komisionet respektive si përfaqësimi më dinjitoz i imazhit të vitit mbarëkombëtar të 80-Vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë



Memoriali ikonë “Nëna Shqipëri”, është Logoja Kombëtare e 80 vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë e përzgjedhur fillimisht nga një komisioni i posaçëm i ngritur pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ku mes shumë propozimeve të dorëzuara nga të rinj të interesuar për të kaluar më pas në fazën përzgjedhëse dhe dakordësisë në Komisionin Shtetëror të drejtuar nga Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi.

Logoja Kombëtare e 80-Vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë që mban autorësinë e Ejona Karkinit, do të jetë simbolikë përfaqësuese dhe do të shoqërojë evenimentet zyrtare dhe shkresat protokollare të Institucioneve Qendrore Shtetërore, si pjesë identifikuese e festimeve dhe si imazh gjatë zhvillimit të aktiviteteve në 2024, shpallur si viti mbarëkombëtar i 80-Vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë me vendim të Këshillit të Ministrave datë 17.01.2024. Logoja Kombëtare 80-Vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë përmban elementët patriotikë kombëtarë dhe u vlerësua nga komisionet respektive si përfaqësimi më dinjitoz i imazhit të vitit Mbarëkombëtar i 80-Vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë.

Autorja 26-vjeçare Ejona Karkini, ish-studente e arkitekturës e njëkohësisht bashkëthemeluese e një startup-i në fushën e dizajnit dhe marketingut, shpjegon se “Logoja Kombëtare 80 vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë përmban Monumentin Nëna Shqipëri, nëpërmjet se cilës u mundova të përcjell lirinë që fal figura e saj me elementë si veshja që valëvitet, që në këtë rast mban në dorë flamurin shqiptar, ndryshe nga skulptura ku ajo ka gjethe dafine dhe një yll. Ashtu si flamuri merr prezencë skenike kur valëvitet nga era, ideja e shiritit që formon 80-en e viteve që gëzojmë si të çliruar, ndjesia që të jep pavarësi”

Të rinj, artistë dhe krijues në fushën e arteve pamore, iu përgjigjën ftesës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për të dhënë kontributin e tyre artistik në konkursin e organizuar me këtë rast, ku konkuruan denjësisht 64 projekte që plotësonin të gjitha kriteret si punime origjinale, të papublikuara më parë, individuale dhe punë të realizuara në grup.

Të gjitha autoritetet publike në



vend do të kenë në shkresa këtë logo

Logoja zyrtare e 80-vjetorit të çlirimit të atdheut përmban simbolin e monumentit “Nënë Shqipëri”, veprë e vitit 1971, realizuar nga skulptorët Kristaq Rama, Mumtaz Dhrami dhe Shaban Hadëri. Imazhi i logos u prezantua më 29 Prill pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Të gjitha autoritetet publike në vend do të kenë në shkresa këtë logo deri në përfundim të vitit.

80-vjetori i çlirimit të Shqipërisë është miratuar si vit jubilar mbarëkombëtar nga Këshilli i Ministrave. Logoja e 80-vjetorit të çlirimit është miratuar nga Komisioni Shtetëror i 80-vjetorit, pas një konkursi të hapur të zhvilluar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Ejona Karkini u përzgjedh si fituesja e konkursit për logon kombëtare të 80-vjetorit të çlirimit mes 64 aplikantëve. Por prej ditës së hënë (30 prill 2024) sipas DPA-së të gjitha autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë, duhet të përdorin shkresat zyrtare me logon e 80-vjetorit të çlirimit. “Modelet e reja të shkresave zyrtare janë miratuar me vendim të Këshillit të Lartë të Arkivave (KLA), dhe përveçse në Fletoren Zyrtare, mund të gjenden edhe në faqen arkiva.gov.al”, thuhet nga DPA. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave shpreh se ky vit shërben për të përkujtuar një përvjetor të rëndësishëm të përfundimit të betejës së shqiptarëve për çlirimin nga pushtimi nazist dhe fashist, si një përkujtesë e detyrës qytetare të çdo shtetasi shqiptar për të mbrojtur atdheun kur ai është në rrezik. “Institucionet shtetërore janë të detyruara ta përcjellin këtë mesazh, përmes logos së miratuar, në çdo shkresë zyrtare, deri në fund të vitit 2024. Kujtojmë,

se mospërdorimi i modeleve të njësuara të shkresave zyrtare nga cilido autoritet publik, shoqërohet nga ndëshkime administrative të përcaktuara në “Ligjin për Arkivat”, thuhet nga DPA.

FITUESJA E KONKURSIT

Në profesion arkitekte, e apasionuar pas dizajnit dhe natyrës, Ejona Karkini na njeh me idenë që frymëzoi krijimin e logos, e cila do jetë pjesë e festimeve zyrtare të sivjetshme në nder të 80-vjetorit të çlirimit të atdheut. Në videon e publikuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit,

26-vjeçarja Karkini, ish-studente e Arkitekturës shpjegon se ideja për logon erdhi natyrshëm, duke qenë se ky vit shënon edhe 80-vjetorin e çlirimit të Shqipërisë. “Simboli i këtij eventi është monumenti “Nënë Shqipëri” realizuar nga skulptorët e njohur Kristaq Rama, Mumtaz Dhrami dhe Shaban Hadëri. Flamuri merr prezencë skenike kur valëvitet nga era dhe prej këtij imazhi erdhi edhe ideja e shiritit që formon 80-ën e viteve që gëzojmë ne si të çliruar, ndjesia që të jep pavarësi”, shprehet Karkini ndër të tjera. Artistë dhe krijues në fushën e arteve pamore, iu përgjigjën ftesës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për të dhënë kontributin e tyre në konkursin e organizuar me këtë rast.



80 VJETORI

Brigada XV Sulmuese u pagëzua në Operacionin e Qershorit 1944



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

ETAPAT LUFTARAKE TË BRIGADËS XV SULMUESE

Operacioni armik i Qershorit 1944 ende vazhdon-te në Shqipërinë e Jugut. 80 vjet më parë kur në mjaft krahina ku zhvilloheshin luftime, si në Opar e në Protopapë, më 29 qershor 1944 nisi rrugën luftarake Brigada e XV Sulmuese (Br. XV S). Në inaugurim e sipër brigada vijoi luftimet. Përvoja që kishin fituar kuadrot dhe luftëtarët e batalioneve partizane e territorial të qarkut të Korçës, ishte e dukshme në batalionet "Fuat Babani", "Hakmarrje", "Skënder Çaçi", "Reshit Çollaku", "Tomori", "Rinia". E gjithë brigade në momentin e inaugurimit kishte gjithsej 750 luftëtarë. Veprimtaria luftarake e Br. XV S kaloi në disa etapa si në etapën e parë nga 29 qershori deri në 20 shtator 1944, ku zona e veprimeve luftarake ishte fusha e Korçës, rruga automobilistike Voskop-Plloçë, Cangonjë-Pogradec-Qafa e Thanës, qyteti i Pogradecit dhe krahinat Gorë-Oparë. Në etapën e dytë nga 20 shtator deri më 30 shtator 1944, u bë marshimi i saj në rrugëkalimin Veliçan i Mokrës, Polis-Labinot me mision të veprimeve luftarake rruga automobilistike nga Qafa e Thanës deri në Xibrakë. Ndërsa në etapën e tretë e cila nisi më 1 tetori dhe vazhdoi deri më 17 nëntor 1944, ku zona e veprimeve luftarake u bë rruga automobilistike Librazhd-Elbasan-Qafa e Kërrabës dhe qyteti i Elbasanit.

GODITJE TË FORCAVE NAZISTE

Luftimi i parë i ashpër që kreu e gjithë brigada ishte goditja e forcave naziste në rrethinat e Pogradecit, të përqendruara kryesisht në grykën e Pogradecit, në minierën e Çervenakës, në Qafë Thanë dhe në fshatin Çëravë. Forcat naziste ishin të armatosura mirë, të mbrojtur në llogore e fortifikata dhe kishin municion të bollshëm. Por, sulmi partizan bëri që armiku të tërhiqet nga rajoni i Gështenjave, pasi nuk i rezistoi sulmit të rrufeshëm të luftëtarëve. Batalioni i katërt i brigadës më 24 gusht 1944 sulmoi një autokolonë gjermane e cila vinte nga Struga për në drejtim të Elbasanit, ku në rajonin e Qukës, në fshatin Xhyrë, ju bë një pritë e organizuar mjaft mirë. Përpjekja ishte tepër e ashpër, pasi dhe një autokolonë nga Elbasani i vjen në ndihmë forcave të ardhura nga Struga. Kështu që u godit njëkohësisht, pasi masat organizative ishin marrë më parë dhe luftëtarët kishin zënë pozicione kyçe të terren-



it. Në pritë e cila vazhdoi dhe luftim trup me trup armiku pësoi dëme si në njerëz dhe në materiale. Mjaft makina dolën jashtë gatishmërisë si dhe u ka shumë municion. Në këtë aksion u kapën dhe mjaft dokumente gjermane. Më 30 gusht, forcat e Br. XV S hynë në Pogradec dhe të gjitha fshatrat buzë rrugës automobilistike nga Lini deri në Podgorie ishin të çliruara. Natën e 24 shtatorit, forcat e batalionit të dytë dhe të tretë goditën një autokolonë që vinte nga Struga për në Elbasan i asgjësuar dhe shkatërruar plotësisht. Nazistëve gjermanë ju kapën sasi të madha me armë dhe municione, por dhe pati humbje në njerëz. Ditë më vonë Br. XV S kaloi lumin Shkumbin dhe u vendos në rajonin e Elbasanit, ku kreu disa goditje kundër forcave naziste. Shtabi i brigadës bëri përgatitjet e duhura, siguroi krahët dhe bëri planin luftarak për të sulmuar dhe çliruar qytetin e Elbasanit, ku ishin strehuar mbi 2.500 ushtarë e oficerë të nazist. Për çlirimin e qytetit sulmi filloi mbi objektivin kryesor që ishte Ura e Zaranikës, lagjja e Kishës dhe kazermat e Krastës. Batalioni i katërt veprimet luftarake i përqendroi në mbulimin e krahëve dhe sulmoi forcat armike njëkohësisht në Xibrakë dhe Labinot. Batalioni i dytë kishte për detyrë të pengonte lëvizjen e armikut në rrugën Elbasan-Tiranë. Sulmi filloi më 5 nëntor dhe pas dy ditë me luftime, batalioni i katërt paralizoi forcat e armikut në fortifikatat e vendosur në Xibrakë dhe në Labinot.

BRIGADË E PËRGATITUR PËR LUFTIME NË QYTET

Në të njëjtën kohë, forcat e batalionit të parë dhe të tretë, përparuan me luftime në drejtimet e parashikuara, duke bërë që qyteti i Elbasanit të rrethohej plotësisht prej tyre. Forcat armike u përqendruan në rrethinat e Shkollës Normale. Forcat e brigadës organizuan një sulm të shpejt, duke njohur vendin, rrugët dhe shtëpitë rezistuese, e detyruan armikun të linte dhe qëndresën e fundit, duke u larguar në mënyrë të çrregullt në drejtim të Tiranës. Forcat naziste në udhëtimin e tyre për në Tiranë pësuan goditje nga forcat partizane që kishin zënë pritë në Bradashesh dhe në lartësitë e Qafës së Kërrabës. Më më 15 nëntor 1944 Elbasani e çlirua. Partizanët e

brigadës kryen dhe detyra të tjera në interes të luftimeve të përgjithshme, duke mbajtur në goditje të vazhdueshme trupat naziste në rrugën Elbasan-Qafa e Kërrabës dhe mori pjesë në çlirimin e Tiranës. Nga brigade ranë dëshmorë të atdheut 50 luftëtarë. Shumë prej tyre ishin kuadro si Istref Maka, Koço Boboshtica, Minosh Gjoka, Rahman Beragishti, Thomaidha Laçka dhe Shaniko Starja, etj. Gjatë luftimeve luftarake Br. XV S çliroi një sipërfaqe prej afro 4000 km katrore nga forcat reaksionare, shpartalloi dhe çarmatosi mbi 2.000 forca xhandaro-balliste në fushën e Korçës dhe në Zonën e Qukës, zuri 72 rob gjermanë, dogji e shkatërroi mbi 200 makina të ndryshme të pushtuesit dhe kapi mjaft dokumente të rëndësishme ushtarake të pushtuesit, etj.

ROLI I KUADROVE DREJTUES

Një rol dhe veprimtari të rëndësishme në veprimtarinë luftarake të Br. XV S luajtën komandant Teki Koloneci, Hero i Popullit dhe komisari Shahin Ruka. Në brigadë luftuan dhe drejtuan dhe kuadro të tjerë drejtues si Meço Starja, Maço Çomo, Arzen Leskoviku, Llazi Stratobërdha e Endri Keko etj. Br. XV S përshkroi një faqe të lavdishme dhe si gjithë brigadat e tjera të UNÇSH, u bë tmerr për armikun dhe shpresë për popullin. Armiqtë dhe tradhtarët nuk e ndjenë asnjëherë veten të qetë, si në fortifikata apo në fushat e betejave si në Pogradec, Qafë Thanë, Librazhd, Mirakë, Xibrakë, Labinot, Elbasan dhe deri në Qafë Kërrabë, në afërsi të Tiranës. Më 18 nëntor 1944 brigada u rreshtua në Divizionin I Sulmues dhe u përqendrua në grykën e Delvinës me detyrë për mbrojtjen e kufirit shtetëror. Në këtë kohë brigade kishte rreth 1.200 luftëtarë. Populli i krahinave të Korçës, Pogradecit, Librazhdit dhe Elbasanit i kujtojnë me admirim dhe respekt heroizmat dhe trimëritë e partizanëve të kësaj brigade në këtë 74 vjetor të krijimit të saj. Përmenoret, lapidarët dhe pllakate përkujtimore të ngritura në vendet ku u kryen luftime dhe aksione, flasin për guximin, për trimërinë e luftëtarëve, komandantëve dhe komisarëve të kësaj njësie lavdi madhe. Kujtimi dhe respekti për dëshmorët e kësaj brigade kanë mbetur pishtar në rrugën e demokracisë të Shqipërisë dhe të popullit.



Komisar, Shahin Rukaj

(Vijon në faqen 8)

KOMENT

Dita e fitores kundër fashizmit 79 vjet pas

Nga Bashkim Hisari

(vijon nga fq. 1)

E vërteta është se LANÇ bashkë me luftën e UÇK-së ishin fitimtare, të drejta dhe të ndershme. Ishin lavdi dhe krenari për popullin tone. Ndaj, kurrë nuk duhet pranuar që të nënvlerohen vlerat e fitores - liria, pavarësia, demokracia dhe të drejtat tona, thot Xhafer Haxhijakupi. “Falë tyre, sot vendosim vetë për të ardhmen tonë. Për shkak të tyre nuk kemi të drejtë dhe nuk guxojmë të jemi të pavendosur për të jetësuar dhe avancuar idealet kombëtare. Vlera e tyre gjithnjë duhet të respektohet dhe nuk duhet lejuar të shtrembërohet historia”, thekson ai dhe shton se veteranët e LANÇ kanë ditur të luftojnë dhe të fitojmë lirinë, të ruajmë paqen dhe të ardhmen për brezat që do vijnë.

Lufta e Dytë Botërore rezultoi si konflikt ushtarak më i përgjithshëm e më i përgjakshëm në historinë e njerëzimit, me pasoja shkatërruese, me shumë dëme materjale dhe pasoja shpirtërore për tërë rruzullin e Tokës. Asnjëherë më parë nuk janë përdorur armë më të tmerrshme. Kurrë më shumë qytete nuk janë djegur nga flakët e bombardimeve. Në asnjë rast nuk kanë vdekur njerëzit në mënyrë më të tmerrshme se sa në kampet naziste të vdekjes. Asnjëherë më parë nuk kanë vdekur më shumë njerëz nga uria, sëmundjet dhe krimet e luftës. Kurrë në historinë e njerëzimit nuk janë vrarë më shumë njerëz. Në mënyrë më mizore humbën jetën rreth 70 milionë njerëz.

Në Shqipëri që në vitin 1939 kishte 1.073.000 banorë u vranë më shumë se 28 mijë ose 2.62 % të popullatës. Në Kosovë 6.200 dhe shumë shqiptar të tjerë që jetonin në Maqedoni, Mal të Zi, Greqi dhe Serbi.

Në Kosovë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, për raportin dhe rezistencën ndaj fashizmit kishte reagime të ndryshme. Shqiptarët qëndronin në një pozicion të vështirë dhe të ndërlikuar, ngase përplasheshin me rryma të ndryshme ku strukturat sociale dhe ekonomike bazuara mbi një shoqëri të polarizuar midis pronarëve të pasur të tokës nga njëra anë, dhe fshatarëve të varfër nga ana tjetër shkaktonin tensione. Të gjitha këto lehtësuan që Mbretëria e Italis të aneksoi pjesën më të madhe të Kosovës dhe t’ia bashkojë Shqipërisë. Pjesën tjetër e pushtuan gjermanët. Për të gjetur mbështetjen e shqiptarëve, regjimi fashist u paraqit si çlirimtar. Protektorati i shtetit fashist Italian përball një ngërçi politik dhe kushtetues punoi me masa praktike të cilat siguruan hegjiminimin e tyre. Lejuan përdorimin e gjuhës shqipe në administratë, organizuan shkollat shqip, lejuan përdorimin e flamurit kombëtar. Për shkak të terrorit shmëvjeçar që ushtroinin sërëbët ndaj shqiptarëve okupatori u mirëpritë dhe gjeti mbështetje në një pjesë të popullatës. Por ky sistem u zëvendësua shpejt me një sistem të ri. Shumica e kosovarëve ngritën zërin dhe dëshmuan forcën e karakterit antifashist. Rreth 55 mijë kosovarë u rreshtuan në anën e drejtë të historisë. Në luftën vendimtare kundër okupatorëve fashistë, luftuan bashkë me partizanët nga Shqipëria dhe çliruan jo vetëm Kosovën e Shqipërinë, por edhe viset tjera të ish Jugosllavisë. Fitorja e tyre ishte kurora e përpjekjeve këmbëngulëse për çlirim kombëtar e social për çfarë jetën flijuan mbi 6.200 luftëtarë kosovarë.

Partija Komuniste e Jugosllavisë, fillimisht kishte përcaktuar disa ide të drejta dhe pragmatike për zgjidhjen e çështjeve nacionale, por ato dështuan për shkak të pengimit nga nacionalizmi serb dhe idesë për Serbinë e Madhe. Shumica e luftëtarëve shqiptarë nuk ishin ithtar të frymës nacionaliste e as përkrahës të politikës shoviniste, por ishin pjesëmarrës të denjë të kërkesave për të drejtat e tyre. Ngadhënjimi mbi fashizmin, liria, drejtësia, vetëvendosja dhe bashkimi me shtetin amë Shqipërinë, ishin burimet kryesore të motivacionit që pjesa më e madhe e kosovarëve të rreshtohen në lëvizjen antifashte nacionalçlirimtare.



Veterani i LANÇ Xhafer Haxhijakupi

Kuadrot shqiptarë të dala nga Lufta e Dytë Botërore, ishin ndër protagonistët kryesorë të ngjarjeve historike. Në ish shtetin Jugosllav u angazhuan për më shumë të drejta nacionale për popullin shqiptar, për liri e barazi. Qëndrimi i tyre politik për këto çështje ishte se populli shqiptar ato të drejta i kishte fituar me pjesëmarrje në LANÇ, të njohura edhe ndërkombëtarisht. Në këto baza janë zhvilluar të gjitha aktivitetet e mëpastajme.

Mirëpo, shteti jugosllav, nën trysinë e forcave regresive serbe dhe me tendencë të ruajtjes së shtetit unitar, nuk ka lejuar të sendërtohet vullneti politik i shqiptarëve që përherë e bënë shumicën e popullsisë së Kosovës dhe ishin etnia e tretë për nga numri në ish Jugosllavi. Pushtetarët serbosllav kishin hartuar plane me qëllime të forta armiqësore, me plot urrejtje e gënjeshtër duke shkelur me dhunë të drejtat e shqiptarëve dhe duke krijuar një gjendje të padurueshme në tërë Kosovën.

Me miratimin e Kushtetutës së vitit 1974, u realizuan disa të drejta, pikësynime dhe dëshira të popullsisë shqiptare, por jo edhe për vetëvendosje.

Njëkohësisht, lëvizja antishqiptare e serbëve mori dimensione të reja. Kulminacionin ajo e arriti në vitet 1998-1999 me pushtetin nacional-shovenist të Beogradit dhe politikën e kriminelit Slobodan Millosheviq. UÇK-ja ju kundërvu makinerisë ushtarake dhe gjenocidit barbar serbë. Me ndihmën e NATO-s ata çliruan Kosovën. Veteranët e LANÇ dhe pasardhësit e tyre ishin ndër të parët që përshëndetën dhe përkrahën botërisht UÇK-në. Në luftën e saj të drejtë për mbrojtjen e popullit, çlirimin dhe krijimin e shtetit të pavarur e demokratik të Kosovës morën pjesë edhe pasardhësit e veteranëve të LANÇ duke dëshmuar se do të vazhdojnë të luftojnë kundër fashizmit dhe të nxisin antifashizmin si trashëgimi civilizues.

Sebja me politikën e saj ultranacionaliste, shoviniste, hegjemoniste për të krijuar Serbinë e Madhe, po vazhdon të mohojë, falsifikojë, keqëinterpretojë historinë dhe po tenton të anatemojë meritat e shqiptarëve në LANÇ. Forcat e prapambetura primitive nacionaliste serbe po vazhdojnë të shfaqin idetë dhe sprehin dashuri ndaj neofashizmit. Pushteti aktualë në Serbi, në krye me Aleksandar Vuçiq, Ivica Daçiç, Aleksandar Vulin, Ana Brnabiç...duke mbuluar rolet e tyre në gjakderdhjen dhe përgjegjësinë për vdekjen e mijëra civilëve të pafajshëm, me mohim të gjenocidit, relativizimin e krimeve të luftës dhe glorifikimin e krimeve dhe kriminelëve të luftës, të cilët kanë edhe vendime të plotfuqishme të gjykatave për krimet që i kanë kryer si dhe me veprimet e tyre politike strategjike, konfirmojnë se neofashizmi është i pranishëm në Serbi. Kjo u vërtetua edhe me miratimin e Rezolutës për gjenocidin në Srebrenicë nga ana e Asamlesë së Përgjithshme të KB më 23, maj 2024.

Fatkeqësisht, edhe në Kosovë, antifashizmit nuk po i jepet rëndësia që meriton. Disa ngjarje të kohëve të shkuara, shumë lehtë po kalojnë në harresë. Gjithnjë e më pak flitet për Luftën e Dytë Botërore. Fitohet përshtypje se LANÇ si pjesë e rëndësishme e historisë sonë, neglizhohet, trajtohet me ose pa qëllim përciptazi. Ngjarjet e mëdha historike në LANÇ dhe ata që ishin qëndresë e vërtetë ndaj pushtuesit dhe fashizmit, po injorohen, zëvendësohen me ngjarje dhe me glorifikimin e disa individëve që kishin

(Vijon në faqen 10)



Aradha partizane “Zejnel Hajdini” në Malësinë e Gjakovës, 1942. Në foto (poshtë nga e majta): Xheladin Nixha dhe Nexhmedin Nixha. Në mes: Fadil Hoxha, komandant. Lartë nga e majta: Xhavit Brovina, i treti lartë nga e majta Qamil Brovina.

HISTORIA

Si e e asgjësuan “Djelmëria e Geghysenit”, marshallin turk Mehmet Ali Pasha (Maxharr Pasha) më 1878-tën.

Djemtë e Geghysenit – “Nderi i Kombit”

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh


Në harkun kohor prej rreth dy shekujsh e deri në ditët e sotme, “Dera e Demushit” ka qënë dhe është e njohur në Malësinë e Gjakoves, në Kosovë e Plavë e Guci, prej së cilës kanë dalë disa breza pasardhës që janë njohur e janë renditur dinjitetshëm në historinë e atdheut e të kombit shqiptar. Janë, jo një por disa djem e burra, që gjenetikiht i përkasin kësaj dere e këtij trangu familjar, të njohur si prijës e luftëtarë në lufrat kundër pushtuesve të huaj. Më së miri e dëshmon historinë e tyre 82-vjeçari Ali Demushi, ish ushtarak shembullor i diplomuar në Shkollën e Bashkuar dhe Akademinë Ushtarake. Janë vërtetë mbresëlënëse episodet e treguara prej tij. Kështu, (sipas tij) i biri i Demushit, Islam Demushi i kohës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, apo “Islam Pasha”, siç e ka quajtur populli i Malësisë së Gjakovës e Rrafshit të Dukagjinit, në Kosovë e deri në Portën e Lartë në Stamboll, është njohur për zgjuarësinë, trimërinë e atdhetarizmin e pashoq. Ai ka organizuar e udhëhequr “Djelmërinë e Geghysenit”, në lufrat e zhvilluara kundër armiqve turkoman, serbo-sllav e çetniko-malazez, si prijës i tyre në të gjitha betejat e zhvilluara. Është e njohur pjesmarrja dhe drejtimi i forcave të Geghysenit me Col e Qerim Delinë në krye të tyre, ku rrethuan e asgjësuan marshallin turk Mehmet Ali Pasha (Maxharr Pasha) më 1878-tën në kullat e Abdulla Pashë Drenit në Gjakovë, të cilin Porta e Lartë e Stambollit e kishte dërguar për të dorëzuar krahinën e Plavë-Gucisë, në zbatim të vendimit famkeq e kriminal të Fuqive të Mëdha në Kongresin e Berlinit në vitin 1878-të.

Islam Demushi është shquar edhe në Luftën e Nokshiqit të dhjetorit 1879 – janar 1880 për mbrojtjen e Plavës e Gucisë nga sulmi i forcave malazeze të Krajl Nikollës, të Malit të Zi, të komanduara nga Mark e Teodor Milani. Ai udhëhoqi e drejtoi në luftime dyzetë djem e burra nga Geghyseni, të inkuadruara në forcat e fisit Krasniqe, ku personalisht, duke luftuar në dyluftim, fyt më fyt me shkjaun malazez ia rrëmbeu flamurin (bajrakun) e fisit Krasniqe, që forcat malazeze ia kishin marrë flamurtarit pasi e kishin vrarë. Janë të njohura historikisht luftimet në betejën e Nokshiqit ku ajo kishte përfunduar fyt më fyt, ku nuk bënte më punë pushka por shpata e jatagani siç e thotë kënga popullore. Në ato luftime ra heroikisht komandanti i forcave shqiptare Jakup Ferri. Humbje të mëdha patën forcat malazeze, por edhe forcat shqiptare patën humbje të ndjeshme. Madhëstsinë e asaj fitoreje e këndon lahutari i malësisë duke nxjerr në pah trimërinë e luftëtarëve shqiptar, ku ndër të tjera thotë: ... “Mark Milani, Mark Milica/Jemi Malësia tan me plisa/jem me plisa e jatagana/ shih asqerit ç’ka ti bana/Në ujë ta mbyta/Krenat ja ndala.”

Lufta e Nokshiqit ka mbetur në histori një nga betejat më të përgjakshme dhe e para në shkallë kombëtare, gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.....

Në ato luftime Islam Demushi kishte marrë me vehte, nipin e tij, djal të ri, Zenel Ahmet Demushi, (babëgjyshi i Ali Demushit), për ta bërë luftëtar trim e të devotshëm për çështjen kombëtare.

Një fakt tjetër që ia rriti besimin në popull si udhëheqës besnik e i pathyeshëm, për Islam Demushin, ishte mosjoshja e mospranimi për të marrë florinin e ofruar nga Pashai Turk, në shkëmbim të largimit të forcave geghysenase nga fronti i luftës e të lejonte marrshimin e ushtrisë turke drejt Shkodrës. Përgjigjia e Islamit për Pashain turk ishte: “Nuk e shes



vatanin për dukatin (florinin) e Stambollit”.

Ish konsulli Francez në Shkodër, Luigj Hekardi, (viti 1853), në faqen 455 të veprës së tij madhore “Historia dhe Përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose Gegërisë”, shkruan ndër të tjera se “Islam Demushi ishte një djalë i ri inteligjent”. Islami, duke qënë i tillë, ishte njëherësh udhëheqës i aftë i djalerisë së Geghysenit në luftën kundër çdo armiku.

QËNDRESA NË MBROJTJE TË QEVERISË SË VLORES DHE REZITENCA KUNDËR FORCAVE MALAZEZE

Në gjurmët e Islam Demushit, vazhdoi edhe i vëllai i tij, Arif Demushi, i cili ishte pjesëmarrës i Kuvendit të Lidhjes së Pejës (me 25 janar 1899 u krijua Lidhja e Pejës ose “Besë-Besë”) me kryetar Haxhi Zekë Biberi i Malësisë së Gjakovës. Lidhja e Pejës hartoi një rezolutë prej 11 pikash dhe “Aktin e Besës” prej 12 pikash, ku si detyrë kryesore u shtrua: “Lufta kundër rrezikut të coptimit të trojeve amëtare nga shtetet fqinjë, shpallja e autonomisë së vendit, shpallja e besës fetare e krahinore dhe ndërprerja e gjakmarrjes ndërmjet shqiptarëve”. Po kështu Arif Denushi me katër Geghysenas të tjetër ishte pjesëmarrës në ngritjen e flamurit në Vlorë nga Ismail Qemali ditën e shpalljes së Pavarësisë me 28 nëntor 1912. Atje qëndruan një muaj në mbrojtje të Qeverisë së Vlorës duke u bashkuar me forcat e Isa Boletinit e të Bajram Currit.

Malësia e Gjakoves (Tropoja) ka përjetuar me shumë dhimbje masakrat e ushtrisë malazeze në vitet 1913 dhe 1915-të, të cilët vranë, prenë, dogjën e shkatërruan malësinë në mënyrë më barbare. Kështu në vitin 1915 Bajram Curri e Hasan Prishtina organizuan qëndresën popullore për të bërë të mundur dështimin e operacionit të koduar “Patkoi” që kishin hartuar armiqtë për pushtimin e Malësisë. Ishin Geghysenasit të parët si çdo herë që i’u përgjigjën thirrjes: “O bini djemt e Geghysenit, se na erd-

hi shkjaun te dera” dhe pa vonuar u ngritën me të madh e me të vogël, me burra e gra në mbrojtje të vëndit, jetës e nderit të tyre, ku një nga këta ishte Çelë Arif Demushi, me vllazninë e tij, ky nip i Islam Demushit. Në luftimet që u zhvilluan në Geghysen më 15 qershor 1915, ra heroikisht Ukshin Avdyli, i shtëpisë së Col e Qerim Delisë, në dyluftim me oficerin malazez, por mbasi kishte vrarë tre ushtarë armiq. Njëkohësisht motra e tij Cucë Avdyli, vrau e plagosi me sakicë (sopatë) dy malazez, duke u plagosur në luftim e sipër por që mundi të shpëtojë nga asgjësimi. Qëndresën në atë luftë të pabarabartë por me heroizëm të pashoq që i shkaktoi armikut humbje të ndjeshme e paraqet ndër të tjera kënga popullore “Kushtrim & mobilizim për fitore”: “Bini djem e bini çika/Geghyseni me sakica (sopata)/ Karadaku (cernogoria) me petica (armë)”.

Në shenjë hakmarrje për humbjet e pësuar, forcat malazeze mundën të kapin rob 16-të geghysenas, të cilët me 24 gusht 1915 i pushkatuan të lidhur dorë më dorë, në shkallën e Grisë dhe i hodhën në humnerë. Dera e Demushit në vazhdimësi nxori djem e burra trima të zotë, që e mbajtën gjallë traditën atdhetare e patriotike të familjes së tyre.

Kështu në vitet ‘20-’30 të shekullit të kaluar, nga kjo derë shquhet Ukë Zenel Demushi (gjyshi i Ali Demushit) i cili ishte një nga bashkëluftëtarët e Bajram Currit që kishte luftuar përkrah tij, për mbrojtjen e trojeve etnike shqiptare. Ai me shumë Geghysenas, Krasniqas, Gashjan e Bytyças, e tjerë kishte luftuar në Shkup, Kosovë, Tiranë e Durrës. Ishte pjesëmarrës i Revolucionit Demokratik të Qershorit më 1924-tren. U vra në vitin 1932, siç u vranë edhe disa bashkëluftëtarë të Bajram Currit dhe vet Bajram Curri më 1925-sën. Po kështu në shenjë hakmarrje në vitin 1926, Ukës ia arrestojnë babain e tij Zenel Ahmet Demushi, e torturojnë atë në burgun e Tiranës aq sa u paralizua, duke mbetur për pesëmbëdhjetë vite në atë gjendje, deri sa vdiq në vitin 1941.

(Vijon në faqen 7)

IN MEMORIAM



Brahim Ukë Demushi, Komandant i Topit
Gjatë luftës Italo-Greke 1940-1941
(personi në rreth)

(Vijon nga faqja 6)

KONTRIBUTI ME ARMË NË DORË GJATË LANÇ

Pas pushtimit fashist të Shqipërisë nga Italia, populli i Tropojës më 7 prill 1941 sulmoi të gjitha postat e karabinerisë italiane të ndodhura brenda rrethit. Kështu Geghysenasit sulmuan postën në Vaun e Fierzës dhe atë në fshatin Gri, duke i shkatëruar armikut rreth 100 të vrarë, të plagosur e të zënë rob. Gjatë këtyre luftimeve italianët mundën të kapin rob në fshatin Arvejë, Bali Halil Demushin, të cilin e pushkatuan barbarisht të lidhur për një pemë në Vaun e Fierzës e pastaj e hodhën në ujrat e lumit Drin, ku kufoma e tij nuk është gjendur kurrë. Në vitin 1980-të është shpallur Dëshmor i Atdheut.

Gjatë pushtimit të Shqipërisë, Italia fashiste mobilizoi në radhët e ushtrisë së saj, me dhunë shumë shqiptarë për ti përdorur "mish për top", duke i dërguar në frontin e Luftës Italo-greke në vitin 1940-1941. Nga trangu i familjes Demushi, mobilizuan dy djem të rinjë: Mujë Bajram Demushi dhe Ibrahim Ukë Demushi (babai i Ali Demushit). Në një kohë të favorshme këta të dy dezertuan nga ushtria italiane. Mujon e kapën, e burgosën sa në Tiranë e sa në Itali, duke e torturuar derisa ndërroi jetë. Në vitin 1970 është shpallur "Dëshmor i Atdheut."

Ibrahim Ukë Demushi që mobilizuar ushtar në vitin 1940, i inkadruar në një bateri artilerie të

• *Ish konsulli Francez në Shkodër, Luigj Hekardi, (vitit 1853), në faqen 455 të veprës së tij madhore "Historia dhe Përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose Gegërisë", shkruan ndër të tjera se "Islam Demushi ishte një djalë i ri inteligjent". Islami, duke qenë i tillë, ishte njëherësh udhëheqës i aftë i djalërisë së Geghysenit në luftën kundër çdo armiku*

Djemtë e Geghysenit – "Nderi i Kombit"


mortajave-top 75/13 mm, në Grupin "Skëndërbeg" të Regjimentit 753 të Artilerisë të së ushtrisë Italiane. E gjithë ajo bateri përbëhej nga shqiptarë me komandant baterie Togerin dibran Siri Strazimiri, një atdhetar i vërtetë. Ajo bateri gjatë luftës Italo-Greke ishte me detyrë luftarake në Kamenicë të Korçës. Ibrahim ishte Komandant i një topi që vet i dytë mbrojti me zjarr forcat e baterisë në tërheqje, duke treguar një akt të rrallë trimërie.

Me mbërritjen e forcave të tërhequra, në ullishtat e Elbasanit, ishte Ibrahim Demushi me Ibrahim Halil Buçpapën. E dy tre shokë të tjerë që organizuan dezertimin nga ushtria Italiane të shumë ushtarëve duke njoftuar e marrë miratimin nga komandanti i baterisë tageri Siri Strazimiri.

Ibrahim Demushi qëndroi një vit në arrati, nga 28 nëntori 1940 deri 22 tetor 1941. Gjatë qëndrimit në arrati, ai mori pjesë aktive në frontin e luftës kundër çetnikëve malazez për mbrojtjen e Plavës e Gucisë, ku nën breshërinë e plumbave të armikut merr kufomën e Geghysenasit, Mujë Bajrami të vrarë tre ditë më parë dhe bashkë me një luftëtar tjetër e varrosi në tokën e Plavës. Idriz Mulosmani që në atë kohë ishte sekretar i komunes së Plavës, e kujton Ibrahim Demushin si një luftëtar trim, me të cilin kishin luftuar kundër çetnikëve malazez.

Lufta Nacional Çlirimtare e Shqipërisë Ibrahimin e gjeti familjarisht në qytetin e Pukës, me banim. Nuk pati mundësi të merrte pjesë direkt në atë luftë çlirimtare, për pasojë të një sëmundje të rëndë tre vjeçare, që ishte shfaqur si shkak i vuajtjeve nga qëndrimi në arrati, por shtëpia e tij me vëllezërit ishte një nga bazat ku u strehuan, ushqyen e u mjekuan disa partizanë gjatë asaj luftime.

Ishte pikërisht kjo trashëgimia e atdhetarizmit të trangu familjar dhe i familjes së nënkolonelit Ali Ibrahim Demushi, ndër breza, që ndikoi dhe ia ushqeu dëshirën për tu bërë oficer i ushtrisë Shqiptare e për t'u renditur dinjitetshëm me elitën e Ushtrisë shqiptare si drejtues i të gjitha niveleve të saj, nga Gramshi në Shkodër dhe sot 82 vjeç – kryetar i OBVL Shkodër. Aliu, kushëriri i tij nënkolonel Ismail Demushi – ish kuadër i lartë drejtues e me



reputacion i Forcave të Rendit dhe ish nëndrejtor i Spitalit ushtarak Tiranë, më i riu Jetmiri – Kryekomisar me rol drejtues (Shef i Sektorit të Forcave Operacionale) në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe dhjetra bashkpatriotë të tyre ndjejnë krenari të ligjshme që janë geghysenas. Sepse emrat e Geghysenasve janë kudo në Kosovë e deri në Amerikë të larguar me kohë për shkaqe të ndryshme por asnjëherë nuk e kanë mohuar ekzistencën e tyre Geghysenas. Është e vërtetë kjo. Portali Limit.al, në një nga reportazhet e tij shkruan se: "Sipas prof. dr. Masar Rizvanolli ish – rektor i Universitetit të Prishtinës, Dah Polloshka (Daut Agë Polloshka) është me origjinë nga Geghyseni, dhe sa herë kishte konflikte me osmanët vinte në Geghysenin e Krasniqes. Po kështu biznesmeni i madh Harry Bajraktari, Zekeria Cana, futbollisti Lorik Cana, shkrimtari Sherif Krasniqi, kampioni i Botës Erkand Qerimaj etj". Kështu disa krahina në Kosovë e gjetiu janë të banuara nga Geghysenas të larguar prej kohësh. Krenaria e tyre për origjinën buron edhe nga dekorata "Nderi i kombit" që ish Presidenti i Republikës Bujar Nishani i akordoi në qershor 2017 fshatit Geghyseni. Madje, veprimtari i njohur Geghysenas, Gëzim Prengzaj, kryetar i Shoqatës "Xheladin Gosturani", me të drejtë shprehet në një intervistë për Limit.al se: "Ndjesia e të qenit qytetar i vendit që i është akorduar nga Presidenti i Republikës "Nderi i Kombit" të krenaron ligjësisht". Sepse, që nga shekujt emri i Geghysenit është gjetur aty ku është burrëria, trimëria, patriotizmi e dituria. Bijtë janë krenaria e çdo brezi, ku secili i transmetoi pasardhësit dashurinë për Atdheun dhe identitetin kombëtar. Rrallë mund të ketë një fshat tjetër që t'i ketë dhënë luftërave të çdo periudhe aq djem sa Geghyseni, rrallë të ketë ndonjë fshat që të ketë kaq vlera intelektuale në krahasim me numrin e popullsisë.

BRIGADA XV SULMUESE U PAGËZUA NË OPERACIONIN E QERSHORIT 1944

(Vijon nga faqja 4)

KOMANDANT, TEKI KOLANECI

Teki Kolaneci lindi në vitin 1913 në fshatin Kolanec të rrethit të Korçës në një familje atdhetare. Luftoi dhe veprroi kundër regjimit të Zogut. Mori pjesë në kryengritjen e Fierit 1935, ku u arrestua dhe u dënua me 15 vjet burg. Gjatë LANÇ-it u shqua si luftëtar dhe udhëheqës ushtarak. Ishte ndër partizanët e parë në rrethin e Korçës, komandant i çetës së Gorë-Oparit në vitin 1942. Me formimin e Br. XV S u emërua komandant i saj. Komandant Tekiu ishte njeri i veprimit, aksionit dhe kudo në luftime drejtoi me kompetencë dhe kishte përgatitje të mirë ushtarake. Shquhej për nismë dhe aksione të guximshme. Pas çlirimit të vendit ka pas funksione të rëndësishme deri në zëvendësministër i Punëve të Brendshme. Mbante titullin e lartë "Heroi i Popullit" dhe mjaft dekorata të tjera.

Shahin Rukaj, lindur më 4 prill 1918, në fshatin Matogji të rrethit Vlorë. Mësimet e para të fillores i

mori në qytetin e Fierit dhe në vitet 1932-1940 kreu shkollën Teknike në Tiranë. U lidh me Lëvizjen Antifashiste, duke marrë pjesë në aksionet e njësiteve guerile të qytetit të Tiranës. Komiteti qarkor i Tiranës gjatë vitit 1943 e kishte ngarkuar me detyrat ushtarake. Në tetor 1943 u emërua komisar politik i Br. II S deri në maj 1944. U emërua komisar politik i Br. XV S deri në çlirimin e vendit. Mbante gradën ushtarake Major. Në dhjetor 1944 emërohet në Ministrinë e Punëve Botore, inspektor. Në vitin 1946 u ngarkua me organizimin e administratës shtetërore të transportit automobilistik të Republikës. Kreu Universitetin e Moskës, në Fakultetin Ekonomi Politike në vitin 1960. Në vitet 1948-1982, ka kryer detyrën e zëvendësministrit të Ministrisë së Ndërtimit, të Ministrisë Miniëra-Gjeologji etj. Ka qenë dhe përfaqësues i përhershëm në Këshillin Ekonomik të Ndhmës Reciproke (KNER) në Moskë dhe së fundi në aparatit të Këshillit të Ministrave, si këshilltar. Dekoruar me urdhra dhe medalje. Mban dy medalje të Republikës Ruse, të "50 vjetori i fitores së Luftës së Madhe Patriotike" dhe medaljen "Zhukov".

85-VJETORI I LINDJES

Qemal Gegollari, intelektual që promovoi vlera qytetarie



Nga Halil Rama

Iafirmuar si pjesë e elitës së Ushtrisë Shqiptare, por edhe si publicist, poet e prozator, që zë vend nderi në historinë e letrave shqipe, Qemal Gegollari ka hyrë me dinjitet në analet e kësaj historie. Ai kultivoi dhe promovoi vlera qytetarie, që në etapa dhe forma të ndryshme, në ecjen e njerëzve me kohën e për kohën, nëpërmjet kontributit të tyre modest dhe historik, kanë komunikuar dhe vazhdojnë të komunikojnë, mesazhe modeste e komplekse, dialogimin e së kaluarës, qartësinë e së tashmes dhe udhën e së ardhmes, ndjenja të shpallura këto, për të kuptuar vazhdimësinë e jetës, krenarisë dhe përjetësisë, vlera që sigurojnë identitetin e qytetarisë dhe dhe inteligjencës.

KUSH ISHTE QEMAL GEGOLLARI

Qemal Gegollari u lind në Gjergjevicë të krahinës së Oparit më 15.06.1939 në një familjeje me tradita e emër të mirë, ku gjenden të kombinuara, mençuria, bujaria, fisnikëria e zemërgjerësia, që ai do t'i mëshironte e perfeksiononte ato gjatë gjithë karrierës së tej prej afro pesë dekadash.


Shkollën fillore e kreu në Voskopojë, ndërsa 7-vjeçaren në Korçë. Në vitin 1953 shkon për studime në Shkollën ushtarake "Skënderbej" Tiranë dhe në përfundim të saj vazhdon studimet e larta në Shkollën e bashkuar të Oficerëve, të cilën e mbaron shkëlqyeshëm dhe titullohet "officer" i kategorisë së parë. Karrierën ushtarake e filloi në Br. 5 K në Gjirokastrë. Edhe pse i ri në moshë e me stazh të vogël, Qemali dërgohet për studime në Akademinë Ushtarake, fakulteti i Artilerisë Tokësore. E mbaroi atë me rezultate shumë të mira dhe në gusht 1967 emërohet në Br. 18 K në Peshkopi. Aty kreu radhazi detyrat nga komandant i grupit deri komandant i Artilerisë së brigadës dhe më pas komandant i Artilerisë në ëish koorporusin e Burrelit. Gjatë kësaj kohe kreu dhe Kursin e Lartë të Kuadrove Shtatmadhorë, i cili më vonë u njehsua me Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm.

Karriera e tij ushtarake vijon si komandant i Brigadës së Artilerisë në Elbasan deri në vitin 1990 kur u lirua nga ushtria..

Në distancë e kam njohur para më shumë se katër dekada, kur ai drejtonte një nga njësitë më të rëndësishme ushtarake, brigadën e Artilerisë në Ish-Korpusin e Burrelit. Bashkëkohësit e vlerësonin komandantin për ato tipare të thjeshtësisë e të komunikimit me drejtues e ushtarë të thjeshtë, por edhe me qytetarë të Burrelit me të cilët qante hallet e tyre të punës e të jetës.

Rezultatet e suksesshme në punë, shumë shpe-

• *Autori i dhjetëra rregulloreve për modernizimin e ushtrisë, drejtuesi i talentuar, miku më i shtrenjtë i oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve e qytetarëve, nderohej gjithnjë prej tyre. Kësisoj, ky intelektual shumëdimensional do të kishte një karrierë gjithnjë në ngjitje, të admirueshme për kolegët e bashkëpunëtorët e tij të shumtë.*



jt sollën edhe vlerësime, për guximin e rrallë, qëndrimin heroik në frontet më të vështira dhe për marrëdhëniet e tij korrekte në shoqëri e familje.

ZË I NJOHUR NË FUSHËN E LETRAVE

Autori i dhjetëra rregulloreve për modernizimin e ushtrisë, drejtuesi i talentuar, miku më i shtrenjtë i oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve e qytetarëve, nderohej gjithnjë prej tyre.

Kësisoj, ky intelektual shumëdimensional do të kishte një karrierë gjithnjë në ngjitje, të admirueshme për kolegët e bashkëpunëtorët e tij të shumtë. Ai kishte marrëdhënie shumë të afërta me ta, ndaj edhe e vlerësonin si një ndër ushtarakët elitare që do të jepte një kontribut të rëndësishëm në modernizimin e konsolidimin e ushtrisë shqiptare, si dhe në veprimtarinë e OBVL-së e OUPSH-së.

Dijet dhe njohuritë e tij kulturore, Qemal Gegollari i shpalosi edhe në veprimtarinë letrare e publicistike. Si zë i njohur në fushën e letrave, fillimet e tij marrin udhë në gazetën "Luftëtari" ku botonte herë pas here shkrime me tematikë të veprimtarisë së Ushtrisë Shqiptare.

Ndërkohë emri i Qemalit zë vend edhe në organe të tjera të shtypit si në gazetën "Bashkimi", "Zëri i Popullit", "Ushtria Popullore" etj. Jeta në pension i favorizoi me shumë kohë për krijimtari.

Njeri kurajoz, i cili me vullnetin e tij bëri të akumulujë më shumë kulturë në botën e letrave për t'u bërë i njohur edhe në gjini e lloje të tjera letrare si në "kronika historike" monografi të figurave të shquara,

• *Qemal Gegollari ishte njeri kurajoz, i cili me vullnetin e tij bëri të akumulujë më shumë kulturë në botën e letrave për t'u bërë i njohur edhe në gjini e lloje të tjera letrare si në "kronika historike" monografi të figurave të shquara, poezi dhe prozë. Ai nuk ndodhet më në jetë, por shembulli i tij frymëzon e do të frymëzojë brezat, pasi la pas një emër të mirë që është vlerë njerëzore për shoqërinë dhe krenari për familjen, të afërmit e miqtë. Dhe Qemal Gegollari e la emrin e mirë*

poezi dhe prozë.

Kjo punë e palodhur dhe hulumtuese bëri që 14 botime veprash të mbajnë autorësinë e tij,, ndër të cilat veçojmë "Opari në rrjedhën e shekujve", "Kronikë vitesh" (vështrim historik, folklorik dhe etnografik); "Figura të shquara dhe dëshmorë të krahinës së Oparit (dy vëllime); "Asllan Gurra, patriot dhe komandant trim", "Gremisja e dashurisë" (roman); "Dekada dhe gjurmë", "E folmja purishte" (fjalor); "Limani i fundit", "Bisedë me veteveten", "Rrezatim përtej viteve", "Profil përmes kujtimeve" dhe "vajza oparake që sfidoi oficerin grek". Këto libra tashmë ndodhen të arkivuara në Bibliotekën Kombëtare, pa lënë mënjanë botimin periodik të gazetës "Opari" pasqyrë e ngjarjeve dhe historisë së vendlindjes.

NJË PERSONALITET SHUMËDIMENSIONAL

E gjithë kjo veprimtari ka treguar se sa e ka dashur Qemali vendlindjen e tij, se sa i lidhur ka qenë me popullin e asaj krahine dhe se sa me dashuri e vërtetësi ka evidentuar luftërat për liri e pavarësi kombëtare të oparikëve. Kontributi i tij e kalon gjeografinë e krahinës, sepse është kontribut edhe për historinë kombëtare.

Si njeri tepër dinamik, në lëvizje dhe kërkim të pasosur njohurish dhe vlerash, ai ishte shumë i lidhur me funksionet shumë të përgjegjshme, të cilat i kreu me devotshmëri, kompetencë e profesionalizëm të lartë deri në majat e Ushtrisë Shqiptare.

Gjithë ky aktivitet i dendur e mjaft produktiv i një personaliteti shumëdimensional si Qemal Gegollari na bën të hulumtojmë më shumë rreth jetës dhe produktit që ai la pas në të mirë të shoqërisë dhe të zhvillimit ekonomik-shoqëror të vendit.

Ai nuk ndodhet më në jetë, por shembulli i tij frymëzon e do të frymëzojë brezat.

Të lësh pas një emër të mirë është vlerë njerëzore për shoqërinë dhe krenari për familjen, të afërmit e miqtë. Dhe Qemal Gegollari e la emrin e mirë.

105 VJETORI I LINDJES

Për heroin e heshtur Liman Fali Bushi

Njëqindpesëvjet më parë, në fshatin Bulaç të zonës së Muhurrit në rrethin e Dibrës, lindi patrioti Liman Fali Bushi, i cili do të hynte në histori si komandanti i kompanisë të repartit ushtarak të Leskovikut, që përballoi me trimëri agresionin grek të 1949-tës në Juglindje të vendit.

Në formimn e tij atdhetar ndikuan shpirti liridashës i muhurakëve, i manifestuar në ngjarjet më kulmore të historisë së Dibrës e të gjithë Shqipërisë. Ndonëse i rritur jetim për nënë, Limani do të ishte i vëmendshëm në odat e burrave kur flitej për qëndresën e të parëve të tij në luftat për liri e pavarësi kombëtare.

Kështu ai krenohet me emrin e Nezir Lleshit nga Bulaçi i Muhurrit, në gardën e Ali Pashë Tepelenës, si edhe me edhe qëndresën në mbrojtje të kufijve nga zaptimi i pyjeve e kullotave nga Haxhi Pashë Zogolli. Këtë krenari ai e shprehete edhe kur rrëfente ato që kishte dëguar nga të parët për qëndresën e muhurakëve ndaj komitëve të Haxhi Pashë Zogolli.

Vite më parë, Limani më pati rrëfyer se: "Aty rreth vitit 1840, Haxhi Pasha, pasi kishte zaptuar pyjet dhe kullotat e disa krahinave të tjera, synonte të zaptonte dhe pyjet e kullotat e Malit të Muhurrit. Malësorët e Bulaçit u organizuan duke vënë në krye Nezir Lleshin, një malësor të thjeshtë, por trim dhe, të ndihmuar nga malësorët e fshatrave përreth, zunë pritat në fushë të Pilajut. Kur tufa prej 3000 krenarësh kaloi në kullotat e Muhurrit, krisi pushka. U vranë 12 sejmënë të Zogollit dhe të gjithë tufën e marrin dhe e sjellin në fsha-



tin Bulaç, ku e ndajnë në mënyrë të barabartë".

Pikërisht i edukuar me këto ndjenja atdhetare, kur Muhurri, si edhe në luftërat e tjera për liri e pavarësi, do të mbështeste fuqimisht edhe Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare (1939-1944), Liman Bushi do të ishte në radhët e atyre partizanëve që formuan brigadën e 18 Sulmuese në Sllatinë, më 18 gusht 1944.

KRONOLOGJI

Më 18 gusht 1944, sipas Urdhërit të Shtabit të Pëgjithshëm u formua në Sllatinë të Dibrës Brigada e 18-të S mbi bazën e tre batalioneve të Dibrës, Martaneshit, Çermenikës si dhe të partizanëve të ardhur nga krahina të tjera të vendit.

Në drejtimin e Brigadës në ditën e formimit ishin Esat Ndreu, komandant, vëllai i patriotit dhe luftëtarit Elez Isuf Ndreu, Zëvendës komandant Zoi Themeli, Miço Kallamata komisar dhe Sotir Vullkani zëvendës komisar. Më vonë u bënë ndryshime në komandën e Brigadës. Petrit Dume u bë komandant brigade, Hilmi Causholli, komisar, Xhevdet Petrela, Zëvendës komandant, Teme Sejko, Zëvendës komisar, Milo Qirko Zëvendës komisar. Gafur Korca ishte komandant i batalionit të parë, Qazim Peshku, komandant i batalionit të dytë, Ajet Rusi, komandant i batalionit të tretë dhe Gafur Mehmeti komandant i batalionit të katërt.

Që me krijimin e kësaj brigade, në radhët e saj

ishte edhe Liman Fali Bushi, i cili gjithë jetën ia kushtoi çeshtjes së atdheut dhe popullit të tij.

Bir i një familje të nderuar dhe me tradita atdhetare ndër breza, Liman Fali Bushi lindi më 10 mars 1919 në fshatin Bulaç të krahinës Muhurr të Dibrës, në një familje të nderuar dhe me tradita atdhetare ndër breza.

Babi i tij, Faliu ka marrë pjesë heroikisht në luftën kundër serbëve më 1913 dhe 1920. Ai ishte shoqëruar i përhershëm i patriotit dhe mendimtarit progresist Dine Hoxha, i njohur edhe si fillozofi popullor në Oborrin Mbretëror (si këshilltari më afër i Mbretit Zog I - Ahmet Zogu).

I rritur dhe i edukuar nga një familje e tillë, edhe Limani që në moshë të re, në pranverën e vitit 1943, mbështeste aksionet luftarake të çetës partizane të Dibrës që komandohej nga Haxhi Lleshi dhe që në fshatin Hurdhë Muhurr, fare pranë Bulaçit kishte bazën e saj në kullën historike të Llan Devës. Limani shërbeu në dhjetra raste si korier i kësaj çete.

Më 18 gusht 1944, me krijimin e Brigadës 18-të Sulmuese, Limani inkadrohet në njësitë e kësaj

QËNDRESA NDAJ AGRESIONIT GREK NË KUFË

Më 2 gusht 2024 mbushen 75 vjet që nga dita kur forcat monarkofashiste greke sulmuan kufirin shqiptar. U luftua për një muaj rresht nga 2 gushti deri më 5 shtator 1949.

Shumë e mbajnë mend konfliktin e pabarabartë në numër, por ndoshta askush nuk e di, se ndër të parët që hapën zjarr kundër grekëve ishte edhe Liman Bushi, nga Bulaçi i Dibrës. Si ish komandant i batalionit të parë të repartit të Leskovikut, në mungesë të çdo komunikimi me autoritete më të larta, Liman Bushi dha urdhër për hapjen e zjarrit ndaj forcave që kishin hyrë 500 metra në territorin shqiptar dhe qëndroi vetë heroikisht në llogoren që kishte hapur.

Ishte një luftë e përmasave dramatike. Ndërsa Greqia vërsuli drejt Shqipërisë mbi 70 mijë forca të armatosura, mbi 50 avionë, 80 tanke dhe një skalion artilerie me afro 400 gjuajtës, kryesisht topa, shteti shqiptar mobilizoi dhe futi në luftën mbrojtëse 10 mijë ushtarë, ndërkohë që po mbante në gatishmëri edhe 30 mijë trupa të tjerë pranë zonës së sulmuar.

Skënder Malindi, një nga drejtuesit e lartë të ushtrisë së asaj kohe më ka treguar se në kohën që zonën kufitare në Juglindje të Shqipërisë me bazë në rajonin e Korçës, të Leskovikut dhe deri në Konispol të Sarandës e në Likojan, u kryen veprime ushtarake në shkallë të gjerë nga shteti i Greqisë, batalioni i Leskovikut që drejtohej nga dibrani Liman Bushi bëri rezistencë me heroizëm të pashoq. Pikërisht për këtë qëndresë Limani u dekorua nga instancat përkatëse qeveritare.

Gjithësesi, kjo nuk mjaftoi që edhe ai, si shumë të tjerë, pasi kishte shërbyer me përkushtim e devotshmëri për 10 vjet si komandant i këtij batalioni, në 1956 përjashtohet padrejtësisht nga partia dhe nga ushtria. Për këtë u sajua pjesëmarrja e një të afërmi të tij në një bandë diversantësh në Përrua të Rine.

Kështu, siç pohon Lazam Lasha, një nga ish funksionarët kryesorë të Partisë e ish-kooperativës bujqësore Muhurr, Limani u detyrua të kthehej në vendlindje, kur për më shumë se 50 vjet punoi në frontet më të vështira të ish kooperativës bujqësore, deri sa doli në pension.

Dhe më e keqja, asnjëherë nuk u fol për këtë hero të heshtur, duke u lënë në harresë qëndresa e tij heroike, si partizan i Brigadës së 18 S dhe si komandant trim i repartit të Leskovikut që luftoi me guxim dhe heroizëm të pashoq kundër agresorit grek të 1949-tës.

Tre djemtë e tij, Setkiu, Afrimi dhe Qemali (por edhe nipi Liman Afrim Bushi), të vendosur me familjet e tyre në Sukth të Durrësit ndjehen krenarë me babain e (gjyshin) e tyre që ka hyë në histori si ushtaraku me formin e kontribute madhore.

Halil Rama



Brigade me detyrën e përgjegjësit të rinisë të Kompanisë. Mori pjesë në të gjitha aksionet e kësaj brigade si në Dibër, Kukës e Prizren. Ai qëndroi trim dhe i vendosur deri në çlirimin e plotë të Atdheut nga pushtuesit nazifashistë.

Me 22 partizanë, mes të cilëve edhe Liman Fali Bushi dhe 5 dëshmorë të LANÇ, Muhuri padyshim hyn me krenari në analet e historisë së asaj lufte të lavdishme.

Në janar 1945 Limani u transferua në repartin kufitar të Leskovikut, ku shërbeu me shumë përkushtim e vendosmëri në mbrojtjen e interesave të atdheut.

LIBRI

Nga ditari i shkrimtarit Daut Hoxha



Fatmir Minguli

Dauti, ky njeri sqimatar që herë më kujton Filias Fogun e herë më kujton Martin Idenin paraqet para lexuesve një veprë dinjitoze, një ditar konstruktiv ku gjithçka flet për një emër : Durrësin.

Mendoj se është i pari libër në llojin e vet, ku çdo ditë e kaq shumë vjet janë regjistruar me kujdesin e qëndrueshmëri mbi muret e kohës.

Kur u njoha me Daut Hoxhën, të cilin e thërrasin me shumë respekt me emrin “profesor” ai sapo kishte botuar shkrimet e para në shtypin e lirë shqiptar të pas viteve 1990. Por ai e çeli rubrikën e botimeve të tij me librin me tregime “Venedika” që u dorëzua për botim në Lidhjen e Shkrimtarëve, kohë kur ishte student i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Tiranës, viti 1950. Fatkëqësisht ky botim u pezullua. Ky libër u botua në vitin 1997, libër që pati një jehonë të madhe në kohën e vet dhe vuri në vend nëpërmjet letërsisë, gabimet e pushtetit monist.

Por vazhdimi i botimeve të këtij autori, jo vetëm me “Venedikën” por deri te libri i tij i dhjetë “Një natë me stuhinë”, tregime 2012, është mishërim i një jete të madhe prej krijuesi. Në se e krahasova me një Martin Iden, e bëra thjeshtë për faktin kryeneç që fati i mbin meu në zemër e mu në mendje disa njerëzve të talentuar.

Daut Hoxha, sot në prag të tetëdhjetëve, me ritmin dhe hovet e një djaloshi punon pa u lodhur,


• *Ditët e fundit doli nga shtypi libri i ri “Njerëz të Durrësit” i Fatmir Mingulit, libër që përmbledh analiza kritike dhe ese mbi veprat e disa prej autorëve durrsakë. Vlejmë të theksojmë se autorët që përfshihen në këtë libër janë zgjedhur spontanisht. Një nga këto shkrime është dhe ky që po paraqes më poshtë për shkrimtarin tashmë të moshuar por aktiv, Daut Hoxha mbështetur në veprën e tij të veçantë “Na e vranë ëndërrën “ vitet 1953 – 1989 “.*

Ishin vitet '90, ndoshta, fillimi i tyre, kur u njoha me një burrë të gjallë, me portretin e vërtetë të një durrsaku, një burrë i mbajtur dhe i veshur me modë.

Miku im, i ndjeri Hysni Çyrbja, i cili më njohu me këtë burrë fisnik, ma prezantoi jo vetëm si shkrimtar.

Kanë kaluar shumë kohë, shumë ngjarje kanë rrjedhur e nuk janë kthyer prapa, ashtu siç thonë latinët “Ujët e lumit ikën por, shtrati mbetet po ai.” Dauti dhe shtrati i tij krijues janë po aty, në qendër të Durrësit, në mes të jetës durrsake.

Daut Hoxha



pa pengesa dhe pa ndalesa për të realizuar veprën e tij më të re “Ditari i një shkrimtari të ardhshëm” ose “Na e vranë ëndërrën – vitet 1953 – 1989.”

Më këtë ditar monumental Daut Hoxha i tregon botës intelektuale se historia duhet shkruar. Ai i tregon shkrimtarëve dhe të tjerëve krijues se historia nuk tregohet nëpër tavolina klubesh ordinerë duke pirë raki apo duke treguar broçkulla.

Daut Hoxha shkruan një histori të Durrësit ndryshe ashtu si dhe kanë vepruar në mënyrën e tyre dr. Ali Sula, prof. Hava dhe Sali Hidri, durrsakë të mirfilltë në gjenezën e tyre.

Libri “Na vranë ëndërrën” i Daut Hoxhës është një rrëfim i stilit prustian, pa efekte anësore, pa nënkuptime e pa mbikuptime. Ngjarjet lëvizin si në pelikola filmike, njerëzit me emrat e tyre renditen si në fjalorë të rëndësishëm njerëzorë. Ngjarjet e festave popullore, fetare apo politiko-shtetërore vendosen nëpër faqet e ditarit si artikuj gazetash të kohës, si titra të dokumentarëve të atyre kohëve.

Tek lexon faqet e këtij libri çdo durrsak gjen veten e tij, në mos emrin e tij, gjen farefisnin apo të njohu-

rit. Që në faqet e para të këtij ditarit – veprë ndjehet një penë që dridhet nga emocionet tek shkruan emra, ngjarje, vende e shumë gjëra të tjera të asaj kohe që kaloi.

E kur thellohem në faqet e shumta të këtij ditarit kaleidoskopik, mendoj përsëri ditën e takimit të parë me autorin e këtij libri. Tek disa faqe ai ka shkruar se ka botuar poezi dhe skica që në ato vite të para të pasçlirimit, i ka çuar në gazetën “Drita” për botim, por që nuk i janë botuar.

Në çdo faqe të librit ndjehet shqetësimi i kohës, lëvizjet e panumurta të specialistëve, për të rregulluar boshllëqet e kohës.

E ndërkohë nuk i ndahet leximeve, ingranohet me rininë, me jetën e përditshme, me problemet e vazhdimet të një shkolle mundësisht teknike pastaj drejt ëndrës së madhe të tij, inxhinierisë mekanike. Por që në fillimet e vitit 1953, fillon historia e Vlashukut e bashkë me të sensi psiko - analitik i autorit, shkrimtarit të ardhshëm, atij shkrimtari që pothuaj do të prekte çdo gjë të jetës shqiptare.

Puna e kryer në Vlashuk dhe në kampe të tjerë të atyre kohëve, për një durrsak si Daut Hoxha është një heroizëm që paralelizohet me “Kënetën” e Fatmir Gjatës dhe me gulagun famëkeq të Solnezhnicinit rus. “Nuk kam shkruar, sepse nuk kam patur bojë, kërkova, por nuk gjeta” – kështu shkruan Dauti diku nëpër faqet e këtij ditarit. Dauti shkruan ditare dhe duke lexuar romane pa fund, punon aty ku e dërgojnë, ku gjurmë ka lënë në SMT – në e Shijakut. Shënime modeste të Daut Hoxhës janë filma dokumentarë pa filtra të dritës partiake.

Ditë të lëvizjes për në kënetën e Tërbufit, skena të provokimeve sigurimse, interferime të jetës familjare me ato politike, janë të shumta në këtë libër madhor. E ç’ nuk gjen në këtë ditar! Gjithçka! E ka ëndje t’a lexojë një bashkohës i Dautit, por edhe një djalë apo vajzë e re. Aty gjenden temat për disertacione në lëmë të sociologjisë etj.

Shkrimet e këtij ditarit janë herë herë si copa dramash, herë herë si poezi, herë herë si pjesëza romanesh të Marsel Prustit në sensin e kohës së humbur. Një kritik i hollë, duke i lexuar në ato kohë këto ditare, do të dallonte sensin e një shkrimtari tepër vrojtues, aspak të qenë dakort me kohën dhe problemet e atëhershme.

Ditari i Daut Hoxhës është një ngrehinë me shumë kate e me shumë dritare, dritare që shohin në të katër anët e horizontit, pa preferencë. Ajo që të bie në sy në këtë ditar është strukturimi i plotë i emblemës letrare – historike të qytetit të Durrësit.

I zhyrur në një jetë të gjallë aktive që në moshë të re, ai deri në fund na tregon jetën e durrsakëve të vërtetë, duke krijuar një katalog letrar ku mund të pyesi çdo i ardhur veten e tij: “Po unë ku ndodhem këtu?”

Jeta e Dautit, plot ndërprej, ku keqardhja më e

Dita e fitores kundër fashizmit 79 vjet pas

(Vijon nga faqja 5)

prioritet kundërshtimin e LANÇ dhe që u mundën në luftën e madhe. Në tekstet shkollore e sidomos në rrjetet sociale dhe në disa media ka plot shkrime të rreme për ngjarjet e vërteta historike dhe trajtime të njëanshme. Nuk përkujtohen dhe nuk shënohen ngjarjet e rëndësishme si Dita e fitores kundër okupatorit nazi-fashist, formimimi i çetave, njësisive, brigadave, divizioneve antifashiste, Këshillave Nacionalçlirimtare, Konferenca e Bujanit, Dita e çlirimit të qyteteve, dëshmorët dhe heronjtë e popullit etj. Në praktikën e përditshme kemi edhe raste të demonizimit të pjesëtarëve të LANÇ. Herë pas here

në debate publike disa individë, në mënyrë të padrejtë dhe me ndjenja negative e përshkruajnë lëvizjen antifashiste dhe liderët e tyre si diçka të ligë. E gjithë kjo në disa vende të Kosovës shoqërohet edhe me prishjen, dëmtimin dhe demolimin e përmendoreve të LANÇ ku kanë qenë të shënuar emrat heronjëve dhe dëshmorëve. Njëherit hiqen edhe emërtimet e rrugëve, shkollave dhe institucioneve që kishin emrat kushtuar luftës antifashiste dhe atyre që dhanë jetën për liri, të ardhmen dhe për një jetë më të mirë për të gjithë brezat.

Pra, kemi tentime për një kthesë që nuk mund dhe nuk duhet të pranohet dhe të tolerohet.

(Vijon në faqen 11)

ESSE

MADHËSHTIA E NJË HEROINE LABE

Neki ÇAKO

HEROINE E POPULLIT
QERIBA KOKA

Koka në jetën e saj të njomë kishte pasur ku ta mësonte idealin e lirisë dhe kishte gjetur kuptimin e flijimit për atdhe. Ajo kishte dëgjuar për trimërinë e Bule Naipi, që kishte thyer prangat e paragjykimëve të kohës, se gruaja është për të bërë fëmijë e për të gatuar, por jo për luftë. Dëshmorja e kombit kishte mësuar gjithë sakrificën e madhe që kishte bërë heroina Bule Naipi, Duke qenë pjesë e lirisë, luftëtarët femra krahas luftës për lirinë e atdheut, luftuan psikologjinë e robit, prandaj ato meritojnë nderimin e fismë.

RRUGËTIMI I GJATË I I
DËSHMORËS QERIBA KOKA NË
BRIGADËN E XII!

Luftëtarja e lirisë, Qeriba Koka, e ngarkuar me detyrën e komisarës së



kompanisë së tretë të batalionit të dytë të brigadës XII Sulmuese, ecte e heshur maleve të Kurveleshit dhe ndoshta, askush nuk e dinte se ç'ka bluante koka e saj, se cilat shkëndija ndrinin shpirtin e saj. Kishin kaluar dimër të vështirë. Majat e maleve ishin të mbuluara me dëborë. Nata ishte e errët.

Kur po vinte dita tjetër, e qershorit të vitit 1944, vëzhguesit e këtij grupi të madh të luftëtarëve, kishin rënë në pritë në mallet e Kurveleshit. Ata, luftëtarët e brigadës XII bashkë me komisarën e tyre, e cila nuk ishte nga ato që ndjekin fatin e betejës nga vëndstrehimi, por ishte në ballë të brigadës, qëndruan heroikisht, sado që ishte një luftë e pabarabartë. Të gjithë ata u sakrifkuan për lirinë tonë duke u ngjitur në altarin e përjetësisë!

REFLEKTIM

Në këto kohë të trishta, ka edhe të atillë që thonë se unë shkruaj për të vdekurit, pasi ata nuk e kthejnë

fjalën... Por, jo! unë, ndjem shumë i nderuar, ndjem se po jetoj kur shkruaj për ata. Askush s'ka të drejtë që me meritat e tyre të shpërndajë lavdi edhe atje ku nuk ka pasur lavdi ngase ata nuk ishin aty kur thirri zëri historik i atdheut, ata nuk ishin aty ku derdhej gjaku për liri. Një nga sokoleshat që luftoi me armë në dorë ka qënë edhe Qeriba Koka.

Luftoi në detyrën e komisarës së kompanisë së tretë të batalionit të dytë të brigadës 12 Sulmuese Nacional Çlirimtare. Pas vrasjes së Qeribasë në organin politik e ushtarak të brigadës xii sulmuese u botua një artikull për aktivitetin dhe bëmat e saj. Aty ndër të tjera thuhej.

"Jeta e saj ishte jetë luftime. Ajo ligjerrojë, organizoi dhe ndezi peshë shumë zemra, mbolli një farë që mbiu e pastër dhe do të mbetet për jetë e tillë. Ajo lajmëroi çirimin se armiku i urryer ishte i destinuar të zhdukej" Trupin e saj të bukur e mbuluan me flamurin kuq e zi. Me nderim e dashuri të madhe partizanët e vendosën rrëzë një ledhi midis brethave.

Rreth saj qëndronin bashkëluftëtarët duke nderuar me dorën e djathtë e duke mbajtur disa minuta zi në shënjë nderimi e respekti. U betuan se do të ecnin nën gjurmët e saj duke kënduar këngë partizane. Lajmi mori dhenë Nëna e saj kur mori vesh nuk qau, por i këndoi me ligjërim që do të trasmetohet brez pas brezi.

*Ishe rritur në ato male
Qeriba e nënëso
Partizane vogëlo!
Në Nivicen tonë krenare
Në një luftë me përpykje
Të zuri plumbi për vdekje.
U vrave për Shqipëri
Me shumë shokë edhe ti
Gjaku juaj është flori
Se u derdh për Shqipëri
Qeriba, o vajzë e djalë i nënëso!*

Qeriba Koka, bijë nga Nivica e Kurveleshit, lindi në vitin 1926. Ajo ishte komisarë kompanie e brigadës XII Sulmuese. U vra në muajin Qershor të vitit 1944, në malet e Kurveleshit, krahinës që bëri emër në historinë e Luftës Nacional - Çlirimtare si edhe më pas, në vitet e rindërtimit të vëndit të shkatërruar nga lufta.

Të gjithë e dimë dhe e besojmë se liria erdhi vetëm me luftë dhe sakrificë, me vuajtje të mëdha e me gjak, të jeni të bindur se ata, dëshmorët e brigadës XII janë sot këtu, bashkë me ne, për të parë se ne nuk i paskemi harruar dhe për të parë nëse amanetin e tyre do t'a çojmë në vënd. Hija e rëndë e luftës, bora e ftohtë, terreni i vështirë në malet e thepisura nëpër të cilat ecnin partizanët e brigadës XII, ku kishte edhe shumë të plagosur, nga njëra anë, e nga ana tjetër ishte ideali i lirisë, lufta për të drejtën historike, fuqia e mbrojtjes së atdheut. Në mesin e luftëtarëve të lirisë, tashti Dëshmore e Kombit, Heoinë e popullit Qeriba Koka! Cilës nënë nuk i dhëmb shpirti për vajzën e saj, kur e di se pjesa e shpirtit dhe trupit të saj duhet të marrë rrugët e botës për të siguruar armë për luftën? Cilës motër nuk i këputet shpirti nga frika se mos pushtuesi ka ngritur kurthe kundër luftëtarëve të lirisë? Asnjërs! Por, luftëtarët e lirisë, luftëtarët e brigadës XII e kishin më të vlefshme lirinë se jetën e tyre.

Ndjenja për liri fiton fillimisht brenda vet njeriut dhe vetëm pastaj robi bëhet zot i fatit të vet dhe si zot i fatit të vet ia gjen kuptimin jetës edhe në sakrificën sublime për liri. Secili luftëtar i brigadës XII ishte vullnetar i thjeshtë, i cili si çdo njeri, derdh lot kur i vritet shoku, ndjen dhembje kur e përshkon plumbi, ligështohet, por prapë vazhdon deri në flijim!

Lufta e Ushtrisë Nacional Çlirimtare kishte filluar përgatitjet për beteja të reja. Në mesin e atyre që po sillnin armët e lirisë ishte edhe Qeriba Koka, luftëtare e lirisë e cila besonte se liria e atdheut bëhet vetëm me armë. Dëshmorja e Kombit, e Brigadës XII, Qeriba

Nga ditari i shkrimtarit Daut Hoxha

(Vijon nga faja 10)

madhe është ajo e shkëputjes nga Universiteti i Tiranës, Dega e Inxhinierisë Mekanike, e ka bërë atë tejet të tejdukshëm, njeri pa komplekse, dashamirës, njeri të besueshëm, po aq të besueshëm sa janë dhe shkrimet e këtij libri.

Për këtë ditar mund të shkruhet shumë, e patjetër që kritika e specializuar do të thotë mendimin e vet. Por ajo që do të "bëjë sy" më shumë do të jenë aspektet politike të cilat Dauti i ka parë më një vështrim shumë të përqëndruar, pikant por edhe transparent. Kështu psh, problemet e socialdemokracisë janë embrionet e kësaj lëvizje njëqind për qind shqiptare. Merita e Daut Hoxhës është se i ka shkruar me kohë këto probleme pak të njohura në publikun shqiptar. Fakt është se Dauti ka botuar edhe një libër më vete për këto probleme dhe që titullohet "Social demokracia - ideali që frymëzoi reformimin", 2010. Po kështu lëvizjet politike të partisë së punës me jugosllavët, sovjetiket, kinezët, Daut Hoxha i sheh në tejqyrën e një Kolombi, duke na dhënë pothuajse gati mendime të cilat janë vërtetuar më vonë. Dauti na ka dhënë një antologji midis ditarit dhe përsiatjeve politiko - shoqërore ku ndriçon më shumë shpirti i kultures së një mësuesi të përjetshëm dhe të një shkrimtari të ardhshëm në kohët e demokracisë.

Sot, kur Daut Hoxha ka përfunduar këtë vepër themelore të jetës së tij është autor i dhjetë librave me tregime, poezi, studime, romane etj. Janë të gjitha këto vepra bija të "nënës" ditar, të kësaj përmbledhjeje jetësore sa të dashur aq dhe shkencore.

Është ndryshe të shkruash kujtime dhe është krejt ndryshe të mbash ditare gjatë jetës tënde. Më duket se një shkencëtar i madh ka thënë se "njeriu që mban shënime, statistika në formë ditari shkencor dallohet nga ai që nuk e bën një gjë të tillë, dmth jo shkencëtar".

Vepra "Na e vranë ëndërrën" është produkt i një sërë studimesh, i një grumbullimi dijesh të pafund, të cilat janë perfeksionuar më tej kur Dauti është diplomuar në Institutin e Lartë Pedagogjik në Shkodër, dega histori - gjeografi.

Por të gjitha tendencat e tij në letërsi u bënë shkruar e hi por edhe ai nuk u tremb. Ndoshta ato pak botime në gazetën "Rinia", "Letrari i ri", "Puna", i dhanë krahë për të kapur më vonë Pegasin e fluturimeve të letërsisë.

Të shkruash një vepër - ditar për një jetë të tërë, plot me perokupime familjare, të cilat autori i përmend me shumë delikatesë në faqet e ditarit, nuk është e thjeshtë as dhe e zakonshme. Është thjeshtë një vepër që e bëjnë njerëzit e talentuar dhe të palodhur, plot me vullnet. Qyteti i Durrësit, durrsakët dhe jo durrsakët do të kenë në bibliotekat e tyre personale apo publike një jetë të shkruar, një film të jetuar, një dramë të ndjerë të një pjese të Shqipërisë.

Durrës mars 2024

DOSSIER

Vlerësim për punën e thelluar studimore të Ing. Kol Dedaj në 120 vjetorin e Shkollës

Iballa e etur për mësim e dituri

• Iballasit gjithmonë kanë qenë një popull punëtor, guximtar, këmbëngulës në arritjen e qëllimeve të tyre, që nuk e dëshirojnë mbetjen prapa të tjerëve. Prandaj edhe hapja e shkollës shqipe në Iballë bën pjesë në këtë kuadër interesash e virtytesh. Për hapjen e shkollës iu drejtuan Ndre Mjedës, poetit të shquar të Rilindjes Kombëtare, i cili mbante lidhje të mira me Pukën, me vendlindjen e të parëve të vet



Xhemal MEÇI

Studjues & Mjeshtër i Madh

Dokumentat e zbuluara kohët e fundit në Vatikan nga dr. Mark Pal Nika, vërtetojnë se shqipja shkruhej që në shek. XIV, sidomos në Shën Palin e Pukës. Kjo traditë shkrimi dëshmon se shqipja duhet të mësohej e të shkruhej edhe më parë se në shek. XIV dhe kjo e njohur në histori që nga fillimi i mijëvjeçarit të parë me një veprimtari të madhe fetare, shoqërore, kulturore e politike deri në shek. XIV – XV.

Një tregues tjetër për këtë arsimim janë Gazullorët, një degë e të cilve u vendosën në Raguzë.

Me dëmtimet shkatërruese që pësoi Puka gjatë ekspeditave osmane për afro dy shekuj, gjithçka u shua.

DOMENIKO PASI PËR INTERESIMIN PËR ARSIMIM NË IBALLË.

(A.Fulv Cordignano, Romë 1933, VII: I)

Përkthyer në shqip i ndjeri Injac Zamputi, Tiranë 1978

D. Pasi, një misionar Italian shumë i vullnetshëm për fenë e krishterë, i cili erdhi në malet e Pukës në vitet 1888-1906, tregon për interesimin e madh të fëmijëve për arsimim bile edhe të rriturve. Duke parë se sa inteligjentë ishin e sa të etur për dije e kulturë, ngriti kurse mësimi në formë shkolle për lutje të besimit të krishterë. Këtë punë e bëri me sukses në Iballë, Berishë, Arst, Mzi, Kokdodë, Bugjon, Fierzë, Mertur dhe në Arripe e Dardhë. Megjithatë, gjatë atyre ditëve, edhe pse kohë dimri e kohë pune, u arit të tërhiqeshin mjaft djem, sa vete D.Pasi e quan "Misioni i çunave", Iballë. "...për nja 10 dite, nga 18-28 nëntor (1888) u mblodhen në mengjes e në darkë mesatarisht nja 30 çuna... edhe në dëborë edhe (pse) fryente një erë e ftohtë, sa nuk ishte e mundur për shumë fëmijë... të veshur keq (dhe) punët që kërkonin blegoria nuk lejojnë që të bashkohen që të gjithë. Disa nga këto lutje mësohen edhe në vargje së bashku me këngë e hymne të tjerë... duke ia përshtatur çdo gjëje temperamentit muzikor të shiptarëve që pëlqejnë "arie" shumë të thjeshta në "minore". Dhe ato vargje ua mësonin njëri-tjetrit dhe i këndonin kur barinjët të dilnin në kullotë me kopetë... Edhe vajzat mësonin nga vëllezërit disa lutje liturgjike.

Dardhë. Djemtë që kishin mësuar lutjet "ishin bërë mësues duke ua kaluar dijen e vet të gjithë të tjerëve, të mëdhej e të vegjël, burra e gra. Edhe unë, me çudinë time të madhe dhe me ngushëllim, shi-

hja duke më dalë para fëmijë, djelmoça e burra që donin të më recitonin lutje për të marrë një rruzare si çmim".

Mertur. "Kalova në Mertur (17 dhjetor 1888, ditën e enjte) te konaku i Gjon Difit. Çunat erdhën me dëshirë të madhe. Ditën e parë pak pas mesnate erdhën të trokitnin te porta. U përgjigja, se ishte tepër shpejt, u nisën, por erdhën dhe dy herë të tjera para se të zbardhte dita". Misionari D. Pasi konstatoi se interesimi për të mësuar prej tij ishte i madh edhe prej burrave.

Edhe kleri mysliman në Pukë, Qërret. Kabash (1904), Iballë, Kryezi, tregonte se Dukagjini (Spas) hapi mejtepe (kurse) njëvjeçar deri në trevjeçar për mësim fetare islame. Zenel Mehaj, një djalë shumë i zgjuar e i vullnetshëm, filloi të mësonte pranë Hoxhë Pukës (Musa Dizdarit) jo vetëm lutjet. Duke parë përparimin e çuan jashtë për shkollim të lartë arabisht për teologji. Si u kthye u bë imami i Pukës. Mësimet fetare i lidhte me ato shqipe dhe në histori. Këto e bënë shumë popullor e të respektuar në popull. Përkrahu kryengritjet e përgjithshme antiturke 1912, revolucionin e 1924-trës, por më pas përkrahu regjimin e Zogut, si zgjidhja e vetme e shpëtimit të vendit nga lakmitë e shovinistëve fqinj dhe revolutive separatiste.

Sadoqë kurset e shkollat e ulta fetare të krishtera e islame përhapnin dije edhe në shqip, prapë dëshira për shkollim në shkolla shqipe mbeti kërkesë në rritje, aq më tepër kur panë se në Dajç (Zadrimë) u hap shkolla shqipe (1901); në Mirditë: Orosh 1900, Spaç 1902, Kashnjet 1903.

1903 SHKOLLË SHQIPE NË IBALLË

Iballasit gjithmonë kanë qenë një popull punëtor, guximtar, këmbëngulës në arritjen e qëllimeve të tyre, që nuk e dëshirojnë mbetjen prapa të tjerëve. Prandaj edhe hapja e shkollës shqipe në Iballë bën pjesë në këtë kuadër interesash e virtytesh. Për hapjen e shkollës iu drejtuan Ndre Mjedës, poetit të shquar të Rilindjes Kombëtare, i cili mbante lidhje të mira me Pukën, me vendlindjen e të parëve të

vet. Ishte me origjinë prej Bardhajve të Kabashit të Kryeziut (M. Quku -Origjina e Ndre Mjedës Gazeta "Bashkimi". Tiranë, 14.08.1988, f. 3). Me ndërhyrjen e Ndre Mjedës pranë ipeshkvisësë Shkodër dhe konsullatës Austro-Hungareze Shkodër, u siguria përkrahja për hapjen e shkollës. Për justifikim para qeveritarëve turq u tha se do të hapej një shkollë fetare. Kjo u bë shkak për mosmarrveshje mes komuniteteve me besime të ndryshme; të krishterë e myslimanë. Për situatën e acaruar në Iballë nuk u bë sa duhet sqarimi e qetësimi i gjëndjes.

Rapsodi i shquar Prendush Gega nxori një këngë me të cilën donte t'u kujtonte iballasve tolerancë e harmoninë ndërfitare të kabashëve në shekuj: "Ti n'Kabash ndonjëherë je kanel/ A ke pa ni xhami n'lam?!Dere per dere kish' e xhami turk e të kshtenë ishin kojshi"....

KOLE ZEJAJ MËSUES NË IBALLË ME 1903-1906

Kujtimet e mbledhura në Iballë e Shkodër në messhekullin XX tregojnë se shkolla e Iballës viteve 1903-1906 ishte shkollë shqipe. Mësuesi i saj që Kole Zezaj, arsimuar për teologji në Bosnje. Zotëronte latinisht, italisht, frengjisht e serbo-kroatisht. Kur u kthye në vendlindje u bind se nëvoja më e ngutshme ishte arsimiti shqip. Filloi punën mësues në Dajç 1901. Kur i propozoi Mjeda që të shkollonte mësues në Iballë, ai pranoi pa hezitim. Para tij po fillonte një provë e vështirë; mësues në zona të thella malore në moshën 27-vjeçare i sapomartuar, me gjendje të brishte ekonomike.

Tërhoqi në shkollë 15-20 nxënësit e parë. Siguroi mjetet më elementare për mësim: në sofër e rreth saj u vendosën këmbëkryq nxënësit e tij; pak letra e ndonjë laps, pllaka me maja plumbi. Kohën e lirë e kalonte duke takuar prind të nxënësve, burra të njohur të dy besimeve. Prania e tij u bë e nëvojshme jo vetëm për shkollën, por edhe për vetë normalizimin e marrëdhënieve në mes komuniteteve myslimanë e katolike.

Shkolla e Iballës u bë vatër arsimimi dhe edukimi



Iballe Puke

DOSSIER



• Festimi i 70-vjetorit të shkollës së Iballës ka qenë një nga ngjarjet më të rëndësishme në veprimtaritë arsimore të ish-rrethit të Pukës. Përgatitjet filluan që me 1973, por meqë interesimi i Ministrisë së Arsimit e të Kulturës nuk u arrit në kohën e duhur, festimi u shtye për me 15 shtator 1974

atdhetar pa dallime besimi e krahinore..

Për ditën e hapjes së shkollës së Iballës ka dy mendime: i pari, shkolla u hap me 15 tetor 1903. (S. Sinani)- Historiku i arsimit të Pukës. Puke, 1974 (Dorëshkrimi në Arkivin e Muzeut të Arsimit); i dyti, shkolla u hap më 15 korrik 1903. (Mentor Quku, drejtori muzeut historik të Shkodrës, studiues i Ndre Mjedës).

Gjendja e pastabilizuar politike (kryengritjet seperatiste 1921, 1922, 1923 dhe revolucioni 1924-ës) u bë shkak që shkolla të qëndronte e mbyllur. Dokumentat tregojnë se shkolla u rihap me (1917-18) e më pas 1921 dhe vazhdoi nga viti në vit, ndërsa mësimi u zhvëndos prej çele të kishës në shtëpine e Mark Marashit i cili lëshoi një dhomë. Mësuesi erdhi me arsim pedagogjik nga Shkodra. Numri i nxënësve arriti në 55 me një rritje nga viti në vit. Mësuesi Lin Çurçia, më 1937 arriti të sillte në shkollë 9 vajza, gjë që shihej si një sukses. 1937-a ishte 25-vjetori i Pavarësisë Kombëtare. Kudo u festua kjo ngjarje. Edhe në Iballë, mësuesi Lin Çurçia bashke me pushtetin vendor, familjet me emër tradicional, si edhe të klerit arriti të përgatis një program të pasur artistik atdhetare. Në mbyllje u bë edhe ceremonia e pajtimit të 11 familjeve në gjakmarrje.

Me kapitullimin e Italisë fashiste në shtator 1943, shkolla u mbyll. U rihap me 1945 me 40 nxënës, me 1946 numri i nxënësve arriti në 115. Në Shkodër u hapën kurse pedagogjike ku mësuesit morën mësimet e para pedagogjike. Në Durrës u hap shkolla "e mesme" pedagogjike me bazë fillore ku u përgatitën qindra mësues. Në çdo fshat u hapën edhe kurse për zhdukjen e analfabetizmit për të rriturit.

Me 1952 u hap klasa e pestë e shkollës unike (shtatëvjeçare), me mësuesin shkodran Hamit Helo-via.

Me 1954 drejtor shkollë caktohet Beslim Hoxha, kuadër me të mesme pedagogjike, organizues i mire i procesit mësimor, drejtues me kulturë, i duruar, me vullnet dhe i dhënë shumë në punët mësimore e drejtuese të shkollës edhe pse 20 - vjeçar. I gjithë brezi ynë ishin 20-23-vjeçar drejtues shkollë në Iballë. Ndue Pjetri drejtor 22-23 -vjeçar. Une (Xh. Meçi) zv/drejtor e drejtor ne moshën 22-23- vjeçar.

PUNA ARTISTIKE NË SHKOLLË

Ngritëm grupin artistik amator dhe përgatitëm një program të mirë për ato kushte. Mungesën e elementit femër e zgjidhëm me tërheqjen e pesë vajzave të shkollës. Na ndihmuan edhe prindërit e vajzave. Mes nxënësve ishte Age Fran Miraka, vajzë inteligjente, e edukuar e me vullnet. Babai i saj kishte vdekur në burg, i denuar politik. Po ajo na i mbante

vajzat të afuara, prandaj e përkrahëm.

Grupi artistik dha shfaqje në Iballë, deri në Mzi. Vendosëm të shkonim edhe në Pukë, ku jeta artistike mungonte. Grupi artistik amator në Pukë bëri përshtypje, sepse kaloi nëpër qytet i veshur me rroba kombëtare duke u rënë veglave muzikore popullore. (Rrobat i kishin siguruar nëpër familjet e nxënësve, rregulloheshim nëpër shtëpi të njohurëve). Nja pesë i mora unë në shtëpi. Me rastin e festës lokale të çlirimit, 16 tetor 1959, komisioni i festës na dha flamurin e kuq të rrethit për rezultate të mira në aktivitetet kulturore me popullin e zonës. Këto arritje më dhanë mundësi që të transferohesha drejtor në shkollën shtatëvjeçare "1 Maj", Fushë Arrëz.

FESTIMI I 70-VJETORIT TË SHKOLLËS

Festimi i 70-vjetorit të shkollës së Iballës ka qenë një nga ngjarjet më të rëndësishme në veprimtaritë arsimore të ish-rrethit të Pukës. Përgatitjet filluan që me 1973, por meqë interesimi i Ministrisë së Arsimit e të Kulturës nuk u arrit në kohën e duhur, festimi u shtye për me 15 shtator 1974.

Përpjekjet për një përgatitje sa më të mirë në rreth qenë të gjithanshme, sidomos në Seksionin e Arsimit e të Kulturës me përgjegjës Ramadan Hoxhën, inspektorët: Zef Delia, edhe të sekretarit të kom. ekzek. Rexhep Toska. S. Sinani me artikujt e tij në shtypin qëndror, sidomos të "Mësuesi" i dha mjaft publicitet 70-vjetorit të shkollës shqipe të Iballës. Ky publiciteti u bë shkak që në këtë festim përvjetori të vinte vetë zv/ministri, Prof. Dr. Hasan Duma.

Drejtori i shkollës Ndue Deda, Mësuesi i merituar, zv/drejtori Ndue Rexhepi, drejtori i shtëpisë së kulturës Iballë, Lin Shahini si edhe mësuesit: M. Cufaj, Gj. Alia, B. Arifaj. Dh. Doko, Z. Vata, D. Qerreti, L. Vata, Gj. Shahini etj. së bashku me kryetarin e këshillit Demush Salih, përballuan një ngarkesë të madhe për përgatitjen e klasave kabinet, mjediset e shkollës, grupin artistik amator, deri në parullat kushtuar 30-vjetorit të çlirimit e 70-vjetorit të shkollës.

Edhe prindërit e nxënësve i pritnin në shtëpitë e tyre të ftuarit e largët. Edhe administrata e kooperativës bujqësore u muar me përgatitjet e ushqimeve e të mencës për të përballuar numrin e madh të të ftuarëve edhe nga fshatrat e zonat përreth. Afro 100 të ftuar shkuan në Iballë që më 14 shtator. H. Duma pyeti për historikun e shkollës dhe emrin e fshatit Iballë. Unë iu përgjigja, duke i thënë se vjen nga burimi vendas: "Iball / ballë me bashkimin e nyjës -i të gjinorës, karakteristike e përdorimit vendas. P.sh. "Shkova i Porav, i Miliska, i Mzi. "Nga ana parëndimore e Iballës, ballë shtëpive të tyre qëndron

mali Bale, nga ku ka dalë emri i fshatit, por me një dobësim të -ll në ll."

Më 15 shtator, në orën 9 - 11 u zhvillua sesioni shkencor, që, për fat të keq, materialet ishin mjaft të ideologjizuara me bardhë e zi. Bardh, çdo gjë që kishte të bënte me vitet e diktaturës komuniste dhe zi, çdo gjë që kishte të bënte me forcat politike të djathta, Mbretin Zogu I, krenët, klerin. As unë nuk i shpëtova kësaj skeme, megjithëse mora guxim e përmenda Kolë Bibë Mirakën mësues 1917 - 18. P.Miska më terhoqi vëmendjen: "S'duhet ta kishe përmendur Kolën, or dorëzi!" Mjaftoi ajo vërejtje, pas tre muajsh u shkarkova nga drejtor i Kabinetit Pedagogjik dhe deri sa dola në pension mbeta mësues i thjeshtë fshati.

Aspektet kryesore të asaj feste u fotografuan për kujtim. Festimi i 70-vjetorit (në fakt i 71-vjetorit) të shkollës shqipe të Iballës ka qenë madheshtor, i përsëritshëm për kohën. Por 120-vjetori duhet mod-el kombëtar.

SHKOLLA NE VITET '70-2000

Më 1976 u hap shkolla e mesme bujqësore dhe pas 12 vitesh ajo arriti kulmin e saj: u diploman 278 maturantë me e pa shkëputje nga puna. Numri i përgjithshëm i nxënësve ishte 750 të cilëve u jepnin mësim 35 mësues.

Gjatë këtyre viteve drejtuan shkollën drejtorë të pasionuar, me përgatitje të lartë arsimore e përvojë të mirë didaktike, si: Zef Delia, Ndue Deda, Ndue Binaku, Bardh Doda, Lekë Hajdari etj.

Me shpërbërjen e kooperativave bujqësore, me rritjen e interesave për pronën private, me lëvizjen e lirë të fshatarëve drejt bregdetit e qyteteve të mëdha si dhe me shtimin e pasigurisë, me dobësimin e shtetit gjatë tranzicionit demokratik, shkolla pësoi goditje e tronditje: u grabitën e u dëmtuan, sidomos baza materiale - mësimore. Në këto kushte numri i nxënësve ra shumë. Pati e ka largime nga klasat e pesta deri në të teta, bile edhe në fillore.

Ja si paraqitet gjendja në fund të vitit shkollor 2002-2003, në 100-vjetorin e vet : gjithsej 218 nxënës (fillore =76, tetëvjeçare, e mesme = 82 -(Statistike e Drejtorisë Arsimore Pukë).

Me 2018 mbyllet shkolla e Mesme. Arsimi 9-vjeçar ra në afro 20 nxënës.

KONTRIBUT ME VLERË I ING. KOLË DEDAJ

Libri "Shkolla e Iballës"... përgatit për botim nga ingj. Kolë Dedaj është një përpjekje me përkushtim nga autori për të pasqyruar sa më të plotë këtë evniment duke sjellë me shumë kujdes përshëndetjet, duke filluar nga Presidenti i Republikës SHT T Z. Bajram Begaj deri te kumtuesit e Sesionit Shkencor, Prof.Dr. Nevila Nika, Prof. Pashk Leka, Prof.Rexhep Uka, si dhe ish-drejtorë e nxënës të kësaj shkolle. Gjithashtu i ilustruar me fotot e kësaj shkolle. Në këtë libër del qartë niveli shkencor i autorit ing. K.Dedaj, duke qëdruar si një lis i lartë mes kolegëve të tij, por duhet ruajtur më shumë nga subjektivizmi dhe familjariteti në studimet e tij. Që ky botim të dalë më i plotë autori me bashkëautorë seriozë, të realizojë së shpejti edhe botimin: "Muzeu i shkollës Iballë në 120-vjetorin e saj", një model për shkollat në shkallë Reputrike e më gjërë. Gjithashtu i duhet kërkuar Presidentit të RSH Bajram Begaj që të dekorohet Shkolla e Iballës si dhe Zotni Dedë Maluta, si organizatori, nxitësi e frymëzuesi si dhe sponsori gjeneral i këtij 120-vjetori.



SUPLEMENTI LETRAT

Rreth librit “Ballkani viktimë e gjeopolitikës”

SHQETËSIMI INTELEKTUAL E ATDHETAR I PANO HALLKOS




SHPENDI TOPOLLAJ

I botuar në vitin 2023, libri “Ballkani viktimë e gjeopolitikës” i Pano Hallkos, autorit tashmë të mirënjohur për praninë e tij me opinionet dhe analizat e mençura e të sakta, vjen për lexuesit, pse jo edhe për politikanët tanë, në një kohë mjaft të trazuar. Ngjarjet që pasuan në planin politik dhe diplomatik të pas viteve nëntëdhjetë të shekullit që shkoi, e kthyen edhe një herë problemin tonë kombëtar në qendër të vëmendjes, veçanërisht pas shthurjes të fqinjit tonë, Jugosllavisë, ku zakonet e vjetra të serbëve ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë, dolën përsëri sheshit me egërsinë e kafshës që po jep shpirt. Nga ana e saj edhe Shqipëria, tashmë me rend demokratik, jo vetëm u hap ndaj Perëndimit dhe u bashkua me organizmat e saj, ku më e rëndësishmja është futja në NATO dhe përpjekjet serioze për pranimin në BE, por edhe luajti ndershmërisht rolin e saj për vendosjen e paqes dhe stabilitetit në Ballkan. Mirëpo, korrektësia e qeverisë tonë, nuk do të mjaftonte për ta realizuar këtë synim, pasi lakmitë, ndikimet, rivendikimet, mosmarrëveshjet, orekset e kundërshtitë e vjetra mes shteteve Ballkanike, ku edhe Greqia vijon të mbajë në fuqi ligjin tashmë anekdotik të luftës, nuk ishin harruar. Po ashtu, edhe ndërhyrjet e vendeve aleate me SHBA në krye, nuk e patën të lehtë të ushtronin autoritetin e tyre, kur arena ndërkombëtare ishte e kërcënuar nga lufta të përgjakshme, ku dallohen ato në Ukrainë dhe Palestinë, pa folur për rrezikun permanent rus, deri tek ajo heshtja kërcënuese e Kinës. Te ne edhe nxënësit e shkollave e kanë të qartë si drita e diellit sesi është luajtur si nga Fuqitë e mëdha dikur, ashtu edhe nga fqinjët tanë, me tkurrjen krejtësisht të padrejtë të shtrirjes tokësore të Atdheut tonë. Prandaj, vendosja nga ana e autorit të këtij libri dinjitoz, e njëjti karikaturë mbi mosmarrëveshjet mbi kufirin e Shqipërisë, marrë nga një gazetë finlandeze, nuk çudit askënd dhe nuk i shkakton askujt të qeshura. Përkundrazi, ajo të shkakton keqardhje dhe të vë në mendime. Dhe në morinë e mendimeve që të sillen në kokë, mbizotëron pyetja se a po dimë të mbajmë qëndrimin e duhur ne shqiptarët para këtyre realiteteve, pra a jemi të orientuar si duhet në marrëdhëniet ndërshtetërore me fqinjët tanë, dhe a po e thonë me guxim fjalën e tyre, qofshin politikanët, qofshin intelektualët? Se këta të fundit ndofta janë më të besuarit në sytë e pop-

ullit dhe me dritën e fakteve i paraprijnë të vërtetës edhe për hapat që ndërmerr politika. Dhe nuk ndihesh mirë kur vëren se fare pak nga ata shprehin shqetësimin e tyre për këto probleme me rëndësi jetike. Kjo del dukshëm edhe në këtë libër, ku autori më së shumti i referohet kryesisht njërit prej tyre, të nderuarit dhe kurajozit Shaban Murati i cili nga ana e tij për këtë libër shprehet: “Këndvështrimi gjeopolitik shqiptar për lidhjet dhe raportet e sotme shqiptare, si dhe të çdo faze të zhvillimit shoqëror e historik, i jep vlera këtij studimi, në drejtim të pasurimit të teorisë shqiptare të marrëdhënieve rajonale e ndërkombëtare”. E gjithë kjo analizë që përfshin më së shumti periudhën e pas shpalljes së pavarësisë është shpërndarë në 43 kapituj, ku secili trajton probleme të veçanta, por të lidhura ngushtësisht me njëra - tjetrën. Në to shohim zhvillimet botërore dhe evropiane që influencuan mbi Ballkanin dhe sidomos mbi fatet e Shqipërisë gjatë historisë e cila i pagoi më shtrenjtë se kushdo rreth e rrotull, ndërhyrjet e të huajve. Dhe si për ta bërë sa më të besueshëm atë çka ai hedh në letër, Pano Hallko po autorëve të huaj u është referuar në pafundësinë e veprave të tyre që lidhen me temat respektive. Ka aty historianë, politikanë e ushtarake grekë, serbë, francezë, gjermanë, etj. deri edhe kujtime, artikuj gazetash e dokumente arkivore të ministrive e të qeverive të ndryshme.

Kuptohet, se për këtë shkallë të lartë njohurish, përveç formimit të tij, Panos i ka shërbyer edhe përvoja në detyrat që ka kryer si gazetar e drejtues shtypi dhe i botimeve ushtarako - shkencore në Ministrinë e Mbrojtjes, etj. por edhe ngulmimi për të gërmuar e studiuar me pasion rreth çështjeve të rëndësishme të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe tonave me të huajt. Se nuk ka sesi ta shohësh Shqipërinë të shkëputur nga bota, nga luftat e zhvilluara dhe nga interesat e të tjerëve. Kështu, fjala vjen, ai merret me marrëdhëniet greko - turke apo franko - ruse, si dhe influencat e dy luftave botërore. Po ashtu, Panua është kujdesur të sqarrojë kuptimin e gjërë të togfjalëshit Lindje - Perëndim. Ai me kulturën e tij e zgjeron konceptin pezhorativ që merr ky togfjalësh, duke dhënë fakte, vepra dhe personalitete me ndikim në kulturën botërore. Nuk flet me termat degiruese të kohës, duke mohuar për hir të qëndrimeve aktuale politike dhe nuk mban ndonjë anësi për hir të religjionit. Nuk u shmanget tezave të gabuara dhe tendencioze të historianëve të tjerë që kanë parë thjesht atë që i leverdis vendit të tyre dhe di të thotë apo më mirë, t'i kundërshtojë me arsye dhe fakte të pavërtetë që ata paraqesin. Madje ai është i prirur të na tregojë më shumë ato që i bashkojnë të dy krahet, të dy qytetërimet, madje edhe të dyja fetë kryesore, duke përqasur më shumë sesa duke ndarë Biblën nga Kur`anni.

Nga ana e tij, ai na jep shembuj, ndofta për shumë, krejt të panjohur, si ai



pohimi i spanjollit Pedro Tafuri cili në viti 1435 shprehej se “Turqit i konsiderojnë vepra të shenjtë ndërtimet dhe godinat e qytetërimin të vjetër klasik dhe nuk i shkatërrojnë ato”. Aq sa kur një ushtar otoman qëlloi me mushqetë brenda në kishë, atij iu pre dora me ferman të sulltanit. Pra, qenë komplekse sjelljet e vendeve apo invazoreve të huaj, pasi po këta nuk i shmangnin fatkeqësitë që u shkaktonin të tjerëve. Dhe ajo që nënkuptohet gjatë leximit të këtij libri është fakti i pranuar nga të gjithë, se ne shqiptarët, askujt nuk i kemi rënë në qafë dhe asnjëherë nuk e kemi ngatërruar Ballkanin duke provokuar lufta edhe pse na janë bërë kaq padrejtësi. E vërteta është se qysh herët Ballkani, i dominuar nga Turqia ka paraqitur interes për Evropën, por ishte François de None që thosh se “Më mirë le ta lemë diskutimin për ndarjen e territoreve pas luftës, kur të kemi gjahun në dorë” dhe që e çoi më tej në vitin 1726 Kryeministri - Kardinal Alberon i cili u paraqiti oborreve evropiane propozimin për “frymëmarrje të gjerë”, ku ndër të tjera parashikonte aneksimin e Egjeut, dhe ndarjen në formë dhuratash të ishujve të tij princave të rinj që do të dalloheshin në luftime. Natyrisht që ashtu sikurse pranonte Luigji i XIV - të, sot nuk janë të modës Kryqëzatat, por kjo nuk i ka penguar që të kërkohen rrugë të tjera edhe më të djallëzuara për shtrirje influencash, çka ka sjellë përherë atë që me të drejtë është quajtur

Ngatërresa Ballkanike. Dhe janë këto synime që sollën krimet e andartëve grekë në vitet 1913 - 14 sipas atij “Protokollit” famëkeq apo mësymjen drejt Shkodrës nga ushtria malazezo - serbe. Edhe sot e kësaj dite, askush nuk habitet kur sheh se po vazhdon po kjo politikë nga ana e Serbisë apo Greqisë të cilave ua dhanë Kosovën dhe Çamërinë dikur, si dhe Maqedonisë të Veriut, ku shqiptarët ende luftojnë për të drejtat e tyre të nëpërkëmbura. Por në kushtet e reja, diplomacisë shqiptare i del detyrë gjetja dhe zbatimi i politi-

kave të zgjuara dhe afatgjata. Me këtë merret më së shumti në këtë libër autori Pano Hallko i cili evidenton gjykimet e tij apo dhe kritikën ndaj rasteve, kur vëren mefshtësi apo mosveprimet e duhura nga ana e qeverive shqiptare gjatë 33 viteve të demokracisë.

Ai jep edhe shembuj të shumtë ku edhe personalitete të ndryshme protestojnë energjikisht ndaj padrejtësive që na bëhen siç është rasti i dy gazetarëve francezë të “Charlie Ebdo” të cilët gjatë vizitës në Athinë i pyetën drejtpërdrejtë kolegët e tyre grekë: pse mbani anën e Milosheviçit, kur ne në Francë me karikaturat tona e bëjmë leckë atë, gjë për të cilën dhanë edhe jetën në 7 janar të vitit 2015. Veç së pari duhet që vetë ne shqiptarët të ngremë zërin dhe të punojmë për këtë. Autori i librit e thotë hapur: “Edhe në Shqipëri do të duhet të vijë dita kur të rishikohen ngjarje dhe figura të cilat kanë zenë vend në histori” dhe vazhdon duke arsyetuar se shqiptarët së pari duhet të përmbushin interesat e Kombit tonë e pastaj të përmbushin ekuacionet e interesave të fuqive të huaja. Ndaj duhet kujdes me varrezat, me kufijtë detarë, me asociacionet e lëshimet e tjera si ndaj grekëve ashtu dhe ndaj serbëve. Se pastaj në situata si ajo e veriut të Kosovës apo e paramilitarëve që kryen sulmin e poshtër në repartin e Peshkëpisë apo e atyre ushtarëve grekë që parakalojnë duke kënduar se me zorrët e shqiptarëve do të lidhin këpucët etj. Penës së Pano Hallkos nuk i ka shpëtuar edhe simpatia për personalitetet e shquara me origjinë shqiptare si Teodor Pangallo, Aristidh Kola e Jorgo Miha apo politikanët e Kosovës së lirë e të pavarur, ashtu edhe qortimet për emisarët e huaj që përkëdhelin Serbinë agresore. Ai, i kthehet sërish gadishullit tonë, me atë nismën e “Ballkanit të Hapur”, ku rreshton tentativat e hershme për realizimin e saj, por që cilido nga udhëheqësit e rëndësishëm synonte të ishte kreu i federatës. Autori e sqaron imtësisht lexuesin me këto histori, por këtu ka vend edhe për një vrejje miqësore: Ishte ky Ballkan i hapur në interes të Aleksandar Vuçiqit, që nuk e pranoi atë edhe Kosova, por që duhet thënë e vërteta, se qeveria shqiptare ishte përkrahësja më e vendosur e saj. Ajo gabimisht u rreshtua me Serbinë dhe u përball me Kosovën, çka çoi në një konflikt fare të panevojshëm mes dy Kryeministrave tanë. Pavarësisht këtij momenti, në këtë libër me shumë vlera, del aspirata e hershme e shqiptarëve për të shkuar e sigurt drejt Evropës. Se është ashtu sikurse citohet Faik Konica i cili qysh në vitin 1907 mësonte se “Zgjidhja ideale do të ishte për shqiptarët të zhduknin njëherë e mirë ndikimet orientale, duke shkëputur çdo lidhje, fetare, morale apo letrare, qoftë me bizantinët, qoftë me turqit. Mirëpo, gjë e bukur të ndodhte kjo në çast. Zgjidhja do të ishte e realizueshme po qe se stëgjyshërit tanë do ta kishin përgatitur me kohë për ne; atëherë neve do të na duhet ta përgatitim këtë zgjidhje për nipat tanë të ardhshëm”. Dhe kësaj përgatitje i shërben edhe ky libër.

SUPELEMENTI LETRAT

Udhëtim në krijimtarinë e autorit Mark Zadeja

FORCA E MENDIMIT TË ÇON DREJT FILOZOFISË

Poeti filozof, Virgjili: "Gjithkush ka kohën e vet për të jetuar. Jeta për të gjithë është e shkurtër dhe e papërsëritshme: Të ngresh lart emrin tënd me vepra, vetëm kjo është e arritja e virtytit"

Kadri Tarelli

P ara pak ditësh, shkrimtari shkodran Mark Zadeja më dërgoi në Durrës, librin e tij "Forca e Mendimit". Titull i thjeshtë, që të bën të mendohesh gjatë. Një vepër me rreth 200 faqe, pa hyrje dhe pa asnjë lloj komenti e vlerësimi. Thjeshtë, drejt për drejt në temë: Shprehje mendimesh, apo siç i quajmë sot me një emërtim modern "aforizma", që unë i quaj "fjalë e jashtme". Janë jo pak, por rreth 3000 mendime që të bëjnë të vrasësh mendjen e të përjetosh. Të gjitha të krijuara nga vetë autori.

Sa për njohje, për Markun më duhet të përmend dy-tri hollësi të vogla në dukje: Akademia Europiane e Arteve e ka vlerësuar z. Mark Zadeja, me titullin "Doctor Honoris Cauza", ndërsa për librin "Qyteti i Vuajtjes", nga kjo Akademi është propozuar si kandidat për çmimin "Nobel". Së fundmi, një vlerësim nga Rumania, motivacioni: "Mark Zadeja. "Nder i kombit": Për vlerat letrare në fushën e pikturës, letërsisë, kritik arti, merita njerëzore dhe atdhetare".

Sipas mendimit filozofik, "emërtimi" i çdo sendi apo dukurie mendore, shoqërore, shkencore, me fjalën tonë apo të jashtme, nuk ka lidhje me përmbajtjen. Ndryshe ndodh me titullin e një libri; ku autori vuan derisa gjen titullin, pasi çdo fjalë apo grup fjalësh, përmbledh në mënyrë lakonike esencën e përmbajtjes dhe kumtin që duhet të përcjellë te lexuesi, që në shikim të parë.

Këtu jam në një mendje me autorin dhe titullin e librit, sepse "Forca e mendimit", nuk është forcë fizike, mekanike, shtytëse, tërheqëse, shpërthyes, lëvizëse, etj. Ky titull ka në brendësi shumë filozofi, sepse ajo është forca që shtyn përpara shoqërinë, që ndërton sistemet, që formon religjionet dhe ideologjitë, që vë në lëvizje masat punëtore dhe popullore, më tej grupimet shoqërore, duke venë në peshore përfundimet dhe pasojat. Dhe, në rastin konkret përmbledh në pak fjalë përgjithësimin teorik e praktik të dukurive, apo ngjarjeve të ndryshme, që të çojnë drejt majës, drejt mendimit filozofik.

Kam përshtypjen se nuk shtova gjë të re në fjalën time rreth librit "Forca e mendimit", që pasi e mbarova, po i rikthehem për ta parë dhe shijuar pak më nge dhe qetësisht, duke bërë një lloj krahasimi me librin "Vuajtja e qytetit", i të njëjtit autor. Libër që u përuar në Durrës pak muaj më parë, Tetor 2023, të cilit i kushtova edhe një shkrim që u publikua në gazeta dhe portale elektronike, me titull: "Vuajtja e Qytetit, si Histori, Psikologji dhe Filozofi". Gazeta "Veterani", Facebook, "Zemra Shqiptare", Gazeta "Dielli", Gazeta "Fjala".


Pikërisht në atë libër, të rrallë për mendimin tim, vura re se autori Mark Zadeja kishte vendosur shumë shprehje, apo mendime të ngjeshura, ku futeshin analiza psikologjike e filozofike, lidhur me ndodhitë e hidhura e të përjetuara fuqishëm, që peshonin shumë në jetën, mendjen dhe shpirtin e qytetit e qytetarëve.

Në fjalën time rendita disa prej tyre, pa ditur dhe pa menduar se Marku kishte kohë që shprehje të tilla i kishte bërë pronë të mendimit të tij filozofik, aq sa kishte botuar edhe një libër të tillë, të veçantë. Pse ta mohoj, është një punë e madhe krijuese, që e vlen të merret në vëmendje, të diskutohet dhe të vlerësohet, duke u ndalur kryesisht të përmbajtja dhe bukuria e fjalës, si mendim dhe forcë artistike. Mendoj dhe jam i bindur, se, nëse bashkohet forca e mendimit dhe me artin e fjalës, atëherë Marku ka bërë një vepër sa të bukur aq edhe të arrirë.

Në çdo faqe që lexoj, shoh se autori ka arritur të futet në natyrën e ndritur të mendimit të hapur, të dukshëm, të prekshëm, njëkohësisht edhe në skutat më të fshehta e të heshtura, të jetës dhe marrëdhënieve njerëzore, familjare, shoqërore, historike, psikologjike dhe filozofike. Ai ka gjetur dhe gdhendur fjalën, për ta vënë në gur themeli të mendimit filozofik. Një punë sa e vështirë aq edhe e fishe, për t'u ngjitur në majë të dijes dhe mendimit krijues.

Ajo që më bën të mendoj dhe të jem në brendësi të librit, është: sa shumë hapësira paska jeta, që copëzat e saj të pasqyrohen si përmbledhje në pak reshta fjalësh. Aq e vërtetë është kjo, sa i bëj pyetje vetes dhe autorit: - A ka fushë të jetës njerëzore që nuk ke trokitur, për të shkrirë mineralin dhe për ta kthyer në metal e gurë të çmuar, në dobi të vetvetes dhe më shumë të shoqërisë.

Si fillim, më duhet të them se Marku është besimtar i mirë, adhuron dhe i falet Zotit. Shumë herë në faqe të



ndryshme të librit, në mënyra të ndryshme i drejtohet Zotit dhe mirësisë së tij. Por nuk mjaftohet me kaq, ai adhuron jetën, dashurinë, rininë, punën, kohën, lirinë, të vërtetën, thjeshtësinë, besën, ndershmërinë dhe drejtësinë, muzikën, librin, poetin dhe poezinë, pikturin dhe pikturën, mirënjohjen, pa harruar të bukurën në natyrë dhe urtësinë në shpirtin njerëzor. Si pjesë e luftës së të kundërtave, autori përcmon të keqen, lakminë, pabesinë, mburrjen, paudhësinë, mosmirënjohjen, ngutjen, fjalën e pa mbajtur, përgjigjen e pamenduar, të shëmtuarën, rendjen pas pasurisë, veseve, dembelizmin, krekosjen, etj. Besoj se gjithçka përmbledhet në këto dy fjalë magjike me vlera universale: - "Krenarinë ruaje për atdheun. Kjo të bën fisnik".

Mendoj të rendis disa fjalë dhe shprehje, që mund dhe duhet t'i shërbejnë gjithsecilit në jetën e përditshme, ca më shumë në pasurimin e mendimit për t'u drejtuar dhe mos gabuar nëpër udhët e jetës.

Besimi te Zoti është shpëtim për shpirtin. Kënaqësia e shpirtit është bamirësia e tij, ndershmëria e vërteta e tij, mirësia-natyra e tij, lavdia-vepra e tij dhe dashuria e vërtetë-çiltërsia e zemrës.

Një njeri, qoftë ky mbret apo kumtar, nuk matet nga pasuria që u le trashëgimtarëve, as nga betejat që fitoi, apo nami i madh që pati, po sa shumë e zhvilloi popullin e vet, sa të mira bëri, sa dashuri e nderim tregoi ndaj tij, e sa shpresa ngjalli tek ai, për të ardhmen.

Asnjë bukuri e kësaj bote, nuk mund të maten me bukurinë e atdheut.

Fillim i mbarë gjysma e punës, porse nëse tërhiqesh, gjysmën tjetër ta marrin të tjerët.

E vërteta e ka strehën e vet tek i ndershmi, ndërsa e drejta tek i urti.

Nuk mund të zgjatet pafundësisht, pasi kështu nuk i shtoj vlera librit, përkundër.....! Por më duhet të them diçka për formën:

Në këtë libër, të gjitha mendimet apo thëniet, janë shtrirë si lulet shumë ngjyrëshe në lëndinë, pa ndarje sinorësh apo gardhesh, ngjyrash e madhësie. Me një fjalë ashtu siç kanë lindur e rritur në kohë dhe hapësirë. Kjo është forma që ka pëlqyer autori dhe e vlerësoj, duke pasur në vëmendje mbi të gjitha përmbajtjen, thelbin e mendimit, dobinë e tij në përditësi të jetës dhe peshën në filozofi.

Jam i bindur dhe i sigurt, se nuk jam i vetmi i dashuruar ndaj thënieve të bukura dhe të ngjeshura në mendim. I kam grumbulluar shumë prej tyre në një



bllok të madh, duke vënë përbir edhe autorin, shkrimtar, mendimtar, poet dhe filozof, shqiptar qoftë, apo nga bota. Shumë të tjerë kanë botuar edhe libra. Në të shumtën e herëve, me këto thënie, stolis fillimin e çdo shkrimi apo poezie, nëpër librat e mi, duke i përafëruar me përmbajtjen e krijimtarisë. Nuk them se lexuesit janë mrekulluar, por të paktën nuk më kanë thënë: Pse?

Mirëpo gjatë punës më lind problemi i gjetjes së tyre sipas tematikës, kështu më duhet të harxhoj mjaft kohë, ndoshta kështu u ndodh edhe të tjerëve. Diku-diku, jam përpjekur t'i grupoj, bie fjala: thënie për atdheun, besën, diturinë, nderin, trimërinë, dashurinë, nënën, gruan, rininë, arsimin, poezinë, muzikën, politikën, artin, sportin, shkencën, etj, etj. Kjo më ndihmon shumë dhe më kursen kohë, njëkohësisht më kujton të mos bëj përsëritje.

Për të qenë i saktë me veten, duke e parë me kujdes të gjithë librin, edhe autori është përpjekur në vetvete për t'i grupuar, por pa i vënë gardh tematikës, duke e lënë këndonjësin t'i verë në "kornizë". Janë shprehje apo mendime, që duhen futur në kujtesë, për t'u përdorur në fjalime, në takime, në biseda në odat e burrave, porosi për të rinjtë, por edhe për ilustrim shkrimesh. Besoj jemi në një mendje: Është bukur kur i dëgjon, më i fisëm kur i mëson. më i fituar kur i zbaton.


Në fund të këtij shkrimi, më duhet të them ato pak fjalë që i kurseva në fillim: Mark Zadeja i ka dhënë përgjigje pyetjes që na shkon nëpër mend, secilit nga ne: - Është forca e mendimit e njerëzve të ditur të çdo kohe, që kanë lënë gjurmë diturie e mençurie, si trashëgim i paçmuar, për të hapur shtegun e të ardhmes. Janë ata që kanë mundur të bëjnë bashkë, mendimin e vyer me artin e fjalës së bukur, duke përcjellë kohën, përvojën dhe mësimin, nga brezi ndër breza.

Dihet, se jeta në kohë dhe historia e saj nuk ka ndarje. Ajo vazhdon rrjedhën pa pyetur dhe pa ndalesë. Të lumtur dhe të fituar janë ata që i përthithin fjalët e urta dhe mendimet e arta, që i bëjnë pronë të tyre, duke shtruar udhën e dijes dhe të suksesit, për një jetë më të mirë, më të begatë, më të paqte dhe më të sigurt.

Urime z. Mark, për këtë libër me vlera në njohje, të çmuar në dobi të gjithsecilit nga ne. Libër që nuk duhet të mungojë në çantë udhëtimi, në çdo bibliotekë vetjake apo familjare.

"Forca e mendimit" është një gur i rëndë në mendimin filozofik shqiptar. Sukses në libra të tjerë!

20 VJETORI I RËNIES NË KRYE TË DETYRËS



PËRJETËSIMI I DËSHMORIT TË ATDHEUT ALLAMAN DERVISHI

- *Akti sublim i Dëshmorit të Policisë Allaman Dervishi dhe figura e tij janë lartësuar në librin "Flutura Shpirti i Allamanit" i autorit Sefer Pasha. Detaje mbi jetën, cilësitë dhe virtytet që mbarte Allamani, dhe familja e tij, janë përshkruar më së miri në këtë libër.*



Nga TRIFON LLUPO

Në Komisarariat e Policisë Rrugore të Tiranës është përvuar më 24 maj 2024 busti në nderim të Dëshmorit të Atdheut, efektivit Allaman Dervishi, 20 vjet pas rënies së tij në krye të detyrës.

Të pranishëm në ceremoni ishin familjarë të Dëshmorit të Atdheut, Zv/ministrja e Brendshme, znj. Romina Kuko; Zv/drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, drejtues i lartë Sokol Bizhga; zv/drejtori i Policisë së Tiranës, drejtues Luigi Vathi dhe shefi i Komisarariatit të Policisë Rrugore Tiranë, kryekomisar Besmir Qibini, të cilët përkujtuan dhe vlerësuan figurën e kolegut të tyre. Allaman Dervishi u lind më 20 shtator 1969, në Kryezi të Pukës. Ai ishte i martuar dhe ka një

djalë. Dervishi ka filluar punë në strukturat e Policisë së Shtetit në vitin 1997, në kohën kur rendi e siguria në Shqipëri ishin të tronditura. Fillimisht në Komisarariat e Policisë Pukë, për të vazhduar më tej në Durrës e Tiranë.

Në shtator të vitit 2003 është emëruar kontrollor linje në Komisarariat e Policisë Rrugore Tiranë, ku shërbeu deri në ditën e rënies në krye të detyrës.

Më datë 24 maj 2004, duke qenë në shërbim së bashku me kolegun e tij Resmi Hasanpapaj, në hyrje të qytetit të Tiranës, vritet në krye të detyrës gjatë kohës që po tentonin të ndalonin një mjet të dyshuar, ndërkohë kolegu i tij mbeti i plagosur rëndë.

Akti sublim i Dëshmorit të Policisë Allaman Dervishi dhe figura e tij janë lartësuar në librin "Flutura Shpirti i Allamanit" i autorit Sefer Pasha. Detaje mbi jetën, cilësitë dhe virtytet që mbarte Allamani, dhe familja e tij, janë përshkruar më së miri në këtë libër. Në emër të familjarëve të Dëshmorit të Atdheut Allaman Dervishi, vëllai i tij Bilbil Dervishi, theksoi se duke përkujtuar Allamanin ne sot përkujtojmë të gjithë ata punonjës policie që si Ai kanë bërë sakrificën më sublime për një Shqipëri më të sigurt.

Këtë 24 Maji, Drejtues të lartë të Policisë së Shtetit, kolegë e familjarë vendosën kurora në memorialin e ngritur në nderim të Dëshmorit të Atdheut Allaman Dervishi, në ambientet e Komisarariatit të Policisë Rrugore.

Allaman Dervishi gjatë gjithë kohës është shquar për devotshmëri, profesionalizëm e korrektësi në përbushjen e detyrës dhe në marrëdhëniet me kolegët e qytetarët, të cilëve u shërbeu me përkushtim të rrallë.